

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7756 E hënë 7 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje

në "Europa e lirë"

Nga ARTON KONUSHEVCI

## A e fitoi Kosova luftën kundër korrupsionit?



Lufta kundër korrupsionit edhe gjatë vitit 2018, sikur edhe në vitet e kaluara, është potencuar nga institucionet e Kosovës si një prej angazhimeve kryesore. Bazuar në...  
Vijon në faqen 22

Opinion

Ditës

Nga ADRI NURELLARI

Protestat e studentëve gjatë muajit dhjetor përbënë një risi në jetën publike të Shqipërisë të mësuar me protesta partiake dhe protestues profesionistë që paguhen... Vijon në faqen 20-21

## Shkëlqimi dhe rënia e protestave studentore



Bledar Shqarthy në polici: Nuk është e imja

## Heroinë në portin e Durrësit, pranga shoferit të kamionit që ikte në Ankona

Sekuestrohen 165 kile kanabis sativa edhe në Tepelenë, prangosen tre

Kapen 4 kilogramë heroinë në portin e Durrësit. Droga ku gjet e fshehur në një kamion që po nisej në Itali dhe u zbulua nga kontrolli që iu bë mjetit. Bledar Shqarthy, shoferi i kamionit është vënë në pranga nga policia ndërsa po merret në pyetje në komisariatit e Durrësit. Heroina kishte vlerë 80 mijë euro dhe tregu...

Në faqen 9

## VENDIMI, ISSH DO TE RILLOGARISE MASEN, JA KATEGORITE QE DO TE PREKEN

# PENSIONET, ZBARDHEN KOEFICIENTET E RINJ

Si do të përlogaritet masa e pensionit të pleqërisë për 2019-ën. Shembujt konkretë bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagat referuese



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në faqen 6-7

EMRAT E VIKTIMAVE

## Aksident i rëndë në Tepelenë, vdesin dy vetë, plagosen pesë të tjerë

Në faqen 12

REAGIMET POLITIKE

## Studentët e banorët e Unazës së Re bashkohen në protesta para Kryeministrit

Në faqen 4

FLET ISH-MINISTRI

## Ndryshimet në qeveri, Kozias: Bushati u largua për shkak të Kosovës

Në faqen 2

KUSH PERFITON

## Bursa në Turqi për studentët e UT, aplikimi dhe dokumentet që duhen

Në faqen 11

YLLI MERJA: PSE DUHET TE PINI VERE



## Doktor Rezar Rusi: Si mund të hiqen gurët në vezikën urinare, këshillat

Suplement

Fituesit kanë 6 muaj kohë të plotësojnë kushtet. Lista e fituesve kalon në janar në bankë

## Kreditë e buta, procedurat e dokumentet për në bankë

Bashkia, rritet shuma dhe afati i shlyerjes për 1104 përfituesit

Plotë 1104 familje dhe çifte të reja të Tiranës, do të kenë mundësi që përmes programit të kreditë së butë të Bashkisë së Tiranës të sigurojnë një shtëpi duke i dhënë zgjidhje strehimit të tyre. Prefekti i Tiranës ka konfirmuar vendimin e Këshillit Bashkiak me anë të të cilit



u miratua lista e fituesve të programit të kreditë të buta, duke i hapur rrugë tashmë zbatimit të tij dhe sigurimit të kreditë me interesa të ulëta nga familjet e shpallura fituese. Burime nga Bashkia e Tiranës kanë bërë me dije se nga...

Në faqen 5

## NDRYSHIMET QEVERIA

Ish-ministri grek bëri të ditur se Bushati kishte qasje tjetër për çështjen e Kosovës

# Ndryshimet në qeveri, Kotzias: Bushati u largua për shkak të Kosovës

"Marrëveshja u arrit, por grekët s'janë gati"

Ndryshimet në qeveri "Rama 2" nuk kanë kaluar pa u komentuar edhe nga Greqia fqinje. Pas deklaratave të pak ditëve më parë të ministrit të Jashtëm plotësues grek, ka ardhur edhe një tjetër deklaratë, kësaj here nga ish-ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias. Gjatë një interviste për mediat greke ai ka folur për ndryshimet në kabinetin qeveritar shqiptar dhe duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek largimi i ish-homologut të tij, Ditmir Bushatit nga pozicioni i ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, me të cilin ai zhvilloi një sërë negociatash të suksesshme për zgjidhjen e problematikave që ekzistojnë mes dy vendeve tona. Sipas Kotzias largimi i Bushatit nga kjo detyrë ka të bëjë pikërisht me çështjen e Kosovës. Sipas tij Bushati kishte një qasje krejt tjetër nga ajo e kryeministrit sa i përket propozimit për korigjimin e kufijve të Kosovës dhe Serbisë. "Ditmir Bushati për mendimin tim nuk u largua sepse ishte shumë vite në krye të diplomacisë, por, sepse kishte një këndvështrim tjetër për çështjen e Kosovës, d.m.th. ishte kundër ndryshimit të kufirit dhe i dyta sepse kishim bërë këtë përpjekjen për një paketë marrëveshje", u shpreh Kotzias. Më tej ai nuk nguron ta vlerësojë punën e Bushatit në krye të diplomacisë shqiptare, si të një njeriu të aftë dhe me personalitetin e duhur për të negociuar. "Ishte një ministër i Jashtëm tepër i guximshëm dhe i vendosur në idetë e tij, më seriozi për të negociuar me Greqinë. Edhe pse i ri, ishte tepër i matur dhe i pjekur. E respektoj shumë për aftësitë e tij", shtoi më tej ish-ministri i Jashtëm grek. Si një prej protagonistëve kryesorë që negocioi me Bushatin për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve mes Greqisë dhe Shqipërisë, Kotzias shprehet se paketa e marrëveshjes ishte arritur. Por ai theksoi se ishin dy elementë që penguan finalizimin e saj,



Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias dhe homoloгу shqiptar Ditmir Bushati

### PËR DITMIR BUSHATIN

"Ishte një ministër i Jashtëm tepër i guximshëm dhe i vendosur në idetë e tij, më seriozi për të negociuar me Greqinë. Edhe pse i ri, ishte tepër i matur dhe i pjekur. E respektoj shumë për aftësitë e tij"

## Paketa antishpifje, PD - ndërkombehtarëve: Rrezikohet liria e mediave

Kryetarja e Komisionit të Medias në Kuvendin e Shqipërisë, deputetja demokratike, Albana Vokshi u ka dërguar një letër institucioneve ndërkombehtarë, ku shpreh shqetësimin e forcës që ajo përfaqëson në lidhje me dy projektligjet e hartuara nga qeveria në kuadër të paketës antishpifje. Në letërën e dërguar ambasadës së Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, OSBE, KiE-s dhe një sërë personalitetesh të larta europiane dhe amerikane, Vokshi shkruan se dy projektligjet e qeverisë po ushtrojnë kontroll mbi median online dhe se janë ndërtuar pa transparencë. "Më lejoni që me anë të kësaj letrë, të kërkoj mbështetjen tuaj për t'i bërë presion qeverisë shqiptare të tërheqë dy projektligjet e propozuara



të censurës, si dhe të bashkëpunojë me organizatat e medias, komunitetin e gazetarëve dhe organizatat ndërkombehtarë për të gjetur rrugën e përmirësimit të cilësisë së medias, duke respektuar në të njëjtën kohë lirinë e medias dhe të shprehjes", shkruhet në letërën e Vokshit për ndërkombehtarët. Më tej ajo evidenton se organizatat

e pavarura të medias, intelektuale dhe opozita i kanë kundërshtuar ashpër këto nisma që sipas saj kërkojnë të nënshtrojnë median online përmes një kontrolli politik që shkon nga gjobotija e tyre deri në ndalimin e lirisë së aksesit në internet. "Katër organizatat të njohura ndërkombehtarë si; Qendra Europiane për Lirinë e Medias, Federata Europiane e Gazetarëve, Reportëret pa Kufij dhe PEN International i kanë kërkuar kryeministrit të tërheqë menjëherë këto projektligje. Përkundër reagimeve të tilla, qeveria duket se synon të vazhdojë me ndryshimet legislative duke pasur parasysh që me shumicën e siguruar të votave në parlament mund të miratojnë edhe ligje të tilla censure", - shprehet deputetja demokratike në letërën e saj.

të pranojnë ligjërisht se lufta mes Shqipërisë dhe Greqisë ka mbaruar tashmë. Nuk do flas për këtë. Kur të flas do i mësoni detajet. Por Greqia, dhe referohem në futitë e djathta dhe të djathta ekstremiste, duhet të bëhet serioze. Ata luajnë si patriotë dhe i vumë re se ku na drejtuan me Qipron. Pseudo-

e para kishte të bënte me mungesën e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri dhe e dyta me faktin se grekët nuk ishin të gatshëm të pranonin se me Shqipërinë nuk ishin më në luftë. "Dua të them këtu se paketën e marrëveshjes e kishim mbyllur, por kishim dy probleme: I pari, Shqipëria nuk kishte Gjykatë Kush-

tetuese të certifikojë reformat e kryera në një sërë çështjesh. Nuk arritëm periudhën e verës, sepse u shpërbë Gjykata Kushtetuese në Shqipëri, nuk kishte lidhje me ne vonesa. Problemi i dytë, ka të bëjë me Greqinë. E kam informuar kryeministrin Cipras me detajsh. Grekët nuk janë të gatshëm



Mbledhja e djeshme në Elbasan

### MARRËVESHJA

"Dua të them këtu se paketën e marrëveshjes e kishim mbyllur, por kishim dy probleme: I pari, Shqipëria nuk kishte Gjykatë Kushtetuese të certifikojë reformat e kryera në një sërë çështjesh. Nuk arritëm periudhën e verës, sepse u shpërbë Gjykata Kushtetuese në Shqipëri, nuk kishte lidhje me ne vonesa"

## Vasili: Ministrat anonim, Rama mund t'i sakrifikojë kur të dojë

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili ka deklaruar dje se përmes ndryshimeve në kabinet, Rama ka zhveshur qeverinë nga politika. Përmes një komenti në rrjetet sociale, Vasili ka theksuar se emërimi i ministrave "anonimë" është një lehtësim që Rama të marrë jo vetëm vendimet që do, por edhe t'i sakrifikojë lehtësisht. "Zhveshja politike e qeverisë është alibi e axhendave antikombëtare të Edi Ramës. Përfundimisht qeveria është zhveshur politikisht nga Edi Rama. Ministrat e ministrive kyçe si Ekonomia dhe Financat, Transportet dhe Energjetika, Ministria e Jashtme dhe Ministria e Brendshme janë politike, por ata nuk janë as teknikë pasi s'përfaqësojnë asgjë as profesionalisht dhe as ndonjë kontributi të shquar social. Janë thjesht një komoditet për kryeministrin, që ai të marrë vendimet që ai do në funksion të axhendave të errëta antikombëtare", shkroi Vasili.

patriotizmi dëmton vendin", - tha Kotzias. Ish-ministri i Jashtëm grek, kritikoi politikën e palës greke dhe të liderit të djathtë Micotakis, për tonet e ngritura sipas tij, në muajt e fundit në raport me Shqipërinë. Ai u shpreh se trajtimi i çështjeve me diplomaci dhe jo zënka të rëndomta vlerësohet gjithnjë

më shumë duke shtuar: "Unë si Kotzias nuk do reagoja kështu me Shqipërinë. Demokracia e Re pranoi anëtarësimin në NATO dhe si vend kandidat për BE pa asnjë kusht, gjatë qeverisjes ndaj sjellja aktuale është hipokrizi nga ana e tyre. Nuk bëhet kështu politika e jashtme", - u shpreh Kotzias.



**MANJANI: MINISTËR PER PARLAMENTIN?! QESHARAK** Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani ka shprehur habinë për pozicionin dhe rolin e ministrit për Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë. "Ministër për marrëdhënie me Kuvendin?! Post qesharak! Ndërkohë kemi nevojë për Kuvend të ndalojë keqqeverisjen!", - shkruan ai.



## Shkreli: Qëndrimi ndaj ministrave kosovarë i turpshëm dhe i pështirë

Zëvendësministri i Transporteve dhe Energjetikës, stu dhuiesi Artan Shkreli e konsideron të turpshëm gjithë debatin e ngritur mbi dy emrat e rinj kosovar që Rama ka propozuar për t'i bërë pjesë e kabinetit të tij qeveritar në nivel ministrash. Nëpërmjet një komentit në rrjetin social 'Facebook', Shkreli shkruan se qëndrimi ndaj Besa Shahinit, e propozuar si ministre e Arsimit dhe Sportit dhe Genti Cakajt i propozuar si ministër i Europës dhe Punëve të Jashtme, vetëm se janë kosovarë, është i pështirë dhe përçarës.

"I turpshëm shqiptarisht, dhe i pështirë deri në kanibalizëm, qëndrimi i disave ndaj dy ministrave shqiptare pse janë nga Kosova!

Nuk më bën diferencë Çami në qeveri e as Kosovari e shqiptari nga Mali i Zi... Njësoj si ai nga Kolonja a Tropoja", - shkruan Shkreli. Sipas tij ata që kanë ngritur këtë furtunë ndaj dy ministrave kosovarë nuk kanë përkatësi politike, por janë kudo. Refuzuesit nuk janë ndarë në llogore politike, por janë kudo... Pasojë e një shkëputjeje njëshekullore mes vedit, që është shfrytëzuar mjeshhtërisht nga të tjerët", - thekson më tej Shkreli. Duke u ndalur edhe të mosha e re e ministrit të ri të Jashtëm, Shkreli sjell në vëmendje rastin e kryeministrit aktual austriak, i cili morri detyrën kur ishte edhe ai në një moshë fare të re. "Kurz ishte 27 vjeç ministër i Jashtëm i një shteti si Austria në një moment shumë delikat", - shkroi Shkreli.

Kryeministri mbledhi për 9 orë ministrat e rinj dhe të vjetër në Labinot të Elbasanit

# Rama: Diskutuan mbi sfidat e 2019, fokusi te punësimi dhe studentët

Në takim të pranishëm Ruçi dhe Balla

Më 5 ministra të rinj të padekretuar, kryeministri Edi Rama ka mbledhur dje për më shumë se 9 orë në një takim informal të mbajtur në një nga resortet e Elbasanit kabinetin e tij "të zgjeruar" qeveritar. Përveç ministrave të rinj, të pranishëm ishin edhe ministrat e shkarkuar dhe të dekretuar nga Presidenti i Republikës, përfshi këtu ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, ministrin e Transporteve dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, ministrin e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla apo edhe ajo e Kulturës, Mirela Kumbaro. Gjithashtu, i pranishëm në këtë mbledhje informale ishte edhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, i cili ndonëse Rama e shkarkoi, Kreu i Shtetit nuk ka pranuar ende ta dekretojë si vendim.

Pjesë e kësaj mbledhje ishte edhe kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, si dhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, ndërsa mësohet se në të është diskutuar mbi prioritetet që duhet të ketë çdo sektor për vitin 2019, kjo edhe si një reflektim mbi gjithë shqetësimet që ngriji jo vetëm protesta e studentëve, por edhe qytetarët nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit. Qeveria ka qenë tepër diskrete në lidhje me çështjet e diskutuara, ndërsa mësohet se qëllimi i këtij takimi të thirrur nga Rama kishte të bënte edhe me njohjen e ministrave të rinj me problematikën që do të përballen me marrjen e detyrës së re, por edhe për të zbutur pakënaqësitë që mund të jenë krijuar te ministrat e vjetër. I vetmi informacion që qarkulloi dje nga ky takim e dha vetë kryeministri, Edi Rama, nëpërmjet një postimi në Twitter se në fokus ishin pikërisht sfidat që e presin qeverinë gjatë 2019. Sipas Ramës në takim u diskutua për rritjen e punësimit, përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe luftën kundër korrupsionit. "Ditë diskutimi për sfidat e 2019-ës sektor për sektor. Në fokus rritja e punësimit dhe sipërmarrjes vendase, përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së shërbimeve publike, masat e reja antikorruption dhe rekrutimi në administratë", - shkruan ai.



Kryeministri Edi Rama me ministrat

**AXHENDA**  
"Ditë diskutimi për sfidat e 2019-ës sektor për sektor. Në fokus rritja e punësimit dhe sipërmarrjes vendase, përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së shërbimeve publike, masat e reja antikorruption dhe rekrutimi në administratë i të rinjve me 9-10. PS-Reforma-Skuadër-Lidership"

## Dekretet e Metës, Kuvendi do mblidhet në seancë të jashtëzakonshme

Kreu i Shtetit, Ilir Meta ka dhe 5 ditë kohë për të vendosur nëse do t'i dekretojë emrat e ministrave të rinj dhe lirin e ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati. Të shtunën ai firmosi dekretet për lirin nga detyra të 7 ministrave sipas propozimeve të bërë nga Rama, ndërsa refuzoi të firmos dekretin për lirin e Ditmir Bushatit. Mësohet se mosdekretimi i lirim të Bushatit nga detyra e kryediplomatit lidhet me faktin se vendi ndodhet vetëm 6 muaj para marrjes së një përgjigjeje pozitive për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian dhe se pozicioni i ministrit të Jashtëm duhet të jetë shumë i konsoliduar. Natyrisht kjo mund të jetë edhe një paralajmërim se Meta mund të refuzojë të dekretojë emrin e Genti Cakës, i propozuar nga Rama për të zëvendësuar Bushatin. Deri më tani në media dhe në publik janë hedhur hije dyshimi se Caka nuk përmush kriteret ligjore pasi nëpërmjet të tjerave nuk zotëron certifikatën e sigurisë. Për këtë qëllim, Meta si për Cakën ashtu edhe për



4 emrat e tjerë të rinj të propozuar nga Rama dhe që nuk vijjnë nga radhët e politikës, ka kërkuar informacione shtesë nga institucionet ligjzbatuese. Më konkretisht për Besa Shahinin, si ministre e Arsimit dhe Sportit, Anila Denajn, ministre e Financave dhe e Ekonomisë, Elva Margaritin, ministre e Kulturës dhe Belinda Ballukun, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Genti Cakën si ministër i Jashtëm, Presidenti Meta ka kërkuar më shumë informacion, pasi ata nuk janë as deputetë. Dekretimi pa asnjë vonesë i Presidentit Meta i një pjesë

të ministrave ka zënë të papërgatitur mazhorancën, e cila tashmë do të duhet të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit për të votuar ministrat e shkarkuar dhe pjesën e dekretuar të ministrave të rinj. Kjo pasi seanca e parë e këtij sesioni është data 21 janar, ndërsa Kushtetuta i jep kohë Kuvendit vetëm 10 ditë kohë për të votuar dekretet e Presidentit për emërim ministrash. Ndaj duke përllogaritur afatet, Kuvendi mund të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme brenda datës 15 janar.

tratit i të rinjve me 9-10. PS-Reforma-Skuadër-Lidership", shkroi Rama, ndërsa publikoi dhe foto nga takimi i djeshëm i qeverisë. Mbledhja e djeshme pason të njëjtë format, ministër më parë nga Rama si në momentin e marrjes së pushtetit në 2013 në Vlorë,

ashtu edhe në krijimin e kabinetit të ri qeveritar në 2018 në Llogora. Mbledhja e djeshme e qeverisë vjen pas ndryshimeve në kabinetin qeveritar dhe dekretimeve të një pjesë të ministrave të rinj nga ana e Presidentit Meta. Të shtunën kreu i shtetit dekretoi vetëm 4 nga 9 emrat e

rinj të propozuar nga Kryeministri Edi Rama, si dhe nuk firmosi shkarkimin e ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati. Presidentit i kanë mbetur edhe 5 ditë kohë për t'u shprehur me dekret për ministrat që janë ende pezull, për të cilët ka kërkuar informacion shtesë.

Kryetarja e LSI-së i bëri thirrje të rinjve t'i bashkohen protestës së studentëve

# Kryemadhi: E keqja jonë nuk është PS, por Edi Rama dhe sekti i tij

## "Qeveria ka vetëm dy socialistë që s'kanë gjë në dorë"

Akuzat ndaj kryeministrit Edi Rama ishin kryefjala e takimit të kryetares së Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi gjatë një takimi me Komitetin Drejtues të LRI-së në Elbasan. E ndodhur në të njëjtin qytet ku edhe kryeministri Rama po mbannte një takim informal me kabinetin e ri qeveritar, por edhe me të shkarkuarit prej tij, Kryemadhi deklaroi se sot në qeveri janë dy socialistë të vetëm. "Nuk është Partia Socialiste e keqja jonë. E keqja më e madhe e shqiptarëve është Edi Rama me sektin e tij kriminal. Shikoni qeverinë e Edi Ramës, nuk ka asnjë socialist. Ky është mesazhi ynë i drejtpërdrejtë për të gjithë socialistët. Më gjeni një socialist në qeveri, përveç Erjon Braçes dhe Pandeli Majkos. Që të dy nuk kanë asgjë në dorë. Kanë vetëm fytyrën e tyre për t'i shërbyer Edi Ramës për të thënë që ka socialistë", tha ajo ndërsa shtoi se LSI i ka hapur dyert për të rinjtë socialistë. Kryemadhi theksoi më tej mbështetjen për protestën e studentëve e cila, sipas saj, është kthyer në problem in kryesor të Ramës. Ajo deklaroi se për të dalë nga kjo situatë Rama po akuzon pedagogët si fajtorët e vetëm. "Janë ata viktimat e radhës që Edi Rama ka vendosur në listën e tij të hakmarrjes duke treguar që faji i gjithë problemeve të universitetit na qenkan pedagogët dhe jo Edi Rama që dështoi me reformën e tij. Dhe pasi të mbarojë me pedagogët do të fillojë varjen në litar të mësuesve të gjimnazëve"



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi gjatë takimit me studentet e Vlorës

**PEDAGOGËT**  
"Janë ata viktimat e radhës që Edi Rama ka vendosur në listën e tij të hakmarrjes duke treguar që faji i gjithë problemeve të universitetit na qenkan pedagogët dhe jo Edi Rama që dështoi me reformën e tij. Dhe pasi të mbarojë me pedagogët do të fillojë varjen në litar të mësuesve të gjimnazëve"

### Deputetja demokratike kërkoi burg për Qëndron dhe Gjijnurin

## Dita e 64 e protestës për Unazën, PD: Sot para Kryeministrit

Banorët e Astirit protestojnë kundër prishjes së shpëtipeve që preken nga projekti i Unazës së Re, pa marrë më parë një dëmshpërblim, i cili do të përlojë arimet me vlerën e tregut. Ata janë shprehur se nuk do të tërhiqen nga kërkesat e tyre dhe rezistencën do ta vijojnë deri në largimin e qeverisë Rama. "Ne nuk tërhiqemi nga rruga deri ditën që të anulohet projekti për Unazën e Re", - tha Dorian Produnari, një nga organizatorët e protestës. Në mbështetje të banorëve ishin edhe deputetët të opozitës, të cilët i bën thirrje qeverisë të anulohet projekti. Deputetja e Partisë Demokratike, Oriola Pampuri u shpreh se sot në burg nuk duhet të ishte Danieli (i riu që



qëlloi me kapsollë policen), por Afrim Qëndro dhe Damian Gjijnuri. "Sot në burg nuk duhet të jetë Danieli, por Damiani, Afrimi dhe Rama. Rilindja kërkoi të shembë shtëpitë tuaja për të ndërtuar klientët që ju shërbejnë atyre. Ne do të vijojmë të qëndrojmë", - u shpreh

Pampuri. Deputeti demokrat, Klevis Balliu, u ka bërë thirrje të gjithë shqiptarëve që nesër t'i bashkohen protestës së studentëve, për t'i dhënë lamtumirën e fundit qeverisë së Rilindjes. "Sot qeveria shqiptare është kthyer në një qeveri familjare, ku burri i gruas bëhet ministër, shokët e gruas bëhen ministrat. Kjo kohë ka marrë fund, ka ardhur momenti që ne t'i japim shuplakën e merituar kësaj qeveri. Ndaj nesër ju ftoj t'i bashkoheni protestës së studentëve dhe ata protestës suaj pasi armiku është vetëm 1, Edi Rama. Nesër të gjithë bashkë para kryeministrit për t'i dhënë lamtumirën e fundit qeverisë së Rilindjes", - deklaroi Balliu.

testën e nesërme. Nuk ka të bëjë me thirrjen e LSI-së, por të një gruaje që lufton për fëmijët e vet. Çdo shqiptar do ta bënte këtë për fëmijët e vet. Nuk mund të mbajmë dreqin brenda, pasi dreqi brenda është mallkim për shqiptarët. Më mirë djepi bosh se dreqi brenda, e pra më mirë pa kryemi-

nistër se sa me Edi Ramën kryeministër. Të bashkohemi për të përmbysur këtë të keqe të madhe. E keqja e madhe nuk është PS, por Edi Rama", - tha Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së falënderoi studentët që sipas saj, mbajtën zjarrin e protestës edhe gjatë festave për të treguar se studentët sh-

qiptarë janë të bashkuar dhe nuk tërhiqen. Ndërkohë që gjatë pasditës së djeshme Monika Kryemadhi pati një tjetër takim me të rinjtë e LSI-së në Vlorë, ku sërish kërkoi prej tyre që të angazhoheshin në protestën e studentëve. Ajo tha se studentët e këtij qyteti i bënë demaskimin më



### Studentët kthehen nga pushimet, sërish protesta para Kryeministrit

Studentët e nisën këtë vit të ri universitar aty ku e lanë në fund të dhjetorit, në rrugë. Sot ata do të bojkotojnë sërish mësimin për t'u bashkuar para Kryeministrit dhe për të kërkuar plotësimin e të gjitha kërkesave të tyre pa asnjë kusht. Por duket se këtë vit të ri ata vijnë edhe me një kërkesë të shtuar që ka të bëjë me abrogimin e ligjit "Për arsimin e lartë". Sipas tyre rrëzimi i ligjit të arsimit të lartë i hap rrugë edhe plotësimi të kërkesave. "Mbldhemi në 08:30 nëpër fakultetet përkatëse për të patur një mirëorganizim dhe në orën 10:00 mbldhemi para Kryeministrit, ky është pikëtakimi ynë. Ndryshe nga herët e tjera që është parashikuar bllokimi i rrugëve, nuk kemi një deklaratë se do të ketë bllokim rruge. Protesta ka që në 11 dhjetor që është shpallur pa afat dhe nuk do të ketë afat, ajo që dihet është që do të jetë protestë masive dhe do të jemi më se të bashkuar", thotë studenti Olger Rakiplari. Studentët kanë zhvilluar disa takime gjatë këtyre ditëve, për tu organizuar në mënyrë që problematikat që u shfaqën gjatë muajit dhjetor sa i përket drejtim të protestës të mos përsëriten. Dy ditë më parë ata u mbldhën në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë, ndërsa mbremë një përfaqësi e tyre u mbldh në Qytetin Studenti.

### Brahimllari: Të largojmë filozofinë e vjedhjes dhe korrupsionit

Protestës së banorëve të Astirit që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës i është bashkuar edhe deputeti i LSI-së, Endrit Brahimllari. Ai theksoi se i gjithë projekti është vërtetur tashmë se është i ngritur mbi një aferë të mirëfilltë korruptive, si sa i përket kompanive që janë kontraktuar për ta ndërtuar atë ashtu edhe në devijimin e projektit të Lumit të Lanës. "Ju jeni dëshmitarë se si Rama tha nuk kam para të dëmshpërblej banorët e Unazës së Re, sepse këto para do t'i çojë për kopshite, shkolla dhe çerdhe. Por çfarë u vërtetua, që ato para shkollin në xhepat e Edi Ramës, Gjijnurit dhe Qëndros. U vërtetua vjedhje e hapur që Rama po bënte në Unazën e Re. Të bashkohemi të gjithë bashkë si kjo protestë, sepse duke qenë të bashkuar do ta largojmë Ramën dhe këtë qeveri. Sot nuk është çështja të largojmë një qeveri e të sjellim një tjetër, sot është çështja të largojmë filozofinë e vjedhjes dhe korrupsionit", - u shpreh Brahimllari.

të madh kryeministrit Edi Rama. "Protesta e studentëve në Vlorë ka një vlerë të jashtëzakonshme, por ka edhe një vlerë historike sepse rinia e ka kuptuar se kur janë të bashkuar dhe kanë një qëllim mund t'ia arrijnë. Demaskimin më të madh Ramës ia bënë studentët e Vlorës. Ai

demaskim iu dha forcë dhe vullnet studentëve. Ne politikantë ndonjëherë bëhemi cinikë, por harrojmë se edhe ne burimim e kemi tek popullin. Asnjëri nga ne nuk e meriton atë që kemi, por më e pakta që duhet të bëjmë është që të kujdesemi për qytetarët", - tha ajo.

**SHPPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbarrimore "E.G. Bailiff Service" me përmbarrues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 21.01.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, Arë me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refet Ramizi , me vlerë fillestare në ankand 420,004(Katerinqind e njezet mijë)LEK..

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**Njoftim për shitje me ankand të tretë**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 568,577 e vijues të K.P.L.C do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e palës debitore B.Kamberaj dhe L.Kamberaj, Pasuria që shitet në ankand përbehet nga :

"Trulli « Godine " me numër pasurie 14/283 ndodhur në Lagjen 10 Korriku dhe e regjistruar pranë ZVRRP-Vlorë, e ndodhur në ZK Nr.8602, volumni 35, faza 144, me sipërfaqe truall 300 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e katit përçhe 117.9 m<sup>2</sup>. Ankandi i tretë fillon me çmimin fillestar në masën 5.644.500 Lekë

Ankandi qendron i hapur 30 dite dhe do të zhvillohet në datë 23.01.2019 në orën 15:00 në Bulevardin "Gj. Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Ofertuesit duhet të lërë çmimin dokumentacionin si dhe të kontaktojnë tel: 67 20 82 543 e-maili llir\_dervishaj@yahoo.com ose WEB www.powerjustice-al.com

Medar KAJOLLI Permbarrues Gjyqësor Privat me seli në Rr. "Urani Pano" Pll.1/3, Kat-2, Tiranë, nxjerr në shitje në ankand pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

-Pasuria Nr. 1/574, Vol.-32, fq.-207, Z.K-8210, lloji Njësi me Sip.-32 mt<sup>2</sup>, Tiranë, me vlerë 3591/072 (Tre mijë e pesëqind e nëntëshejë e një mijë e shtatëshejë e dy) Lekë., në pronësi të debitorit Z.Besnik Binaku.

Shitja e pasurive të paluajtshme do të behet (Zhvillohet) në datë 11.01.2019, ditën e Premte, ora 16.00 në Zyren e Permbarruesit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, në Adresën Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kat-2, Tiranë.

Per informacione mund të kontaktoni Nr.Tel:+355 66 20 333 03, ose në Adr.-email:medar.kajolli@gmail.com

Fituesit e kredive të buta kanë 6 muaj kohë të plotësojnë kushtet e bankës

# Kreditë, procedurat dhe dokumentet që duhet të plotësojnë fituesit

Lista me 1104 fitues i kalon bankës në mes të janarit

**P**lotë 1104 familje dhe çifte të reja të Tiranës, do të kenë mundësi që përmes programit të kredisë së butë të Bashkisë së Tiranës të sigurojnë një shtëpi duke i dhënë zgjidhje strehimit të tyre. Prefekti i Tiranës ka konfirmuar vendimin e Këshillit Bashkiak me anë të të cilit u miratua lista e fituesve të programit të kredive të buta, duke i hapur rrugë tashmë zbatimit të tij dhe sigurimit të kredisë me interesa të ulëta nga familjet e shpallura fituese. Burime nga Bashkia e Tiranës kanë bërë me dije se nga mesi i janarit lista e fituesve do të jetë aktive dhe do t'i kalojë Bankës Raifaisen me të cilën Bashkia e Tiranës ka lidhur marrëveshje për zbatimin e këtij programi social.

**PROCEDURAT**

Pas këtij momenti të gjithë personat që kanë gjetur emrin në listën fituese të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Tiranës duhet të paraqiten pranë një prej degëve të bankës, për të nisur procedurat e mëtejshme për plotësimin e të gjithë kushteve për marrjen e kredisë. Ata duhet të paraqiten me emrin e përfutuesit dhe të marrin listën e dokumentacionit që banka aplikon në politikat e saja të kredisë edhe për qytetarët e tjerë. Kryesisht bëhet fjalë për paraqitjen e vërtetimit që je i punësuar, vërtetim page, fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë familjare, si dhe sigurimin e jetës. Ndërkohë që paralelisht përfutuesit duhet të gjejnë edhe apartamentin ose shtëpinë që duan të blejnë dhe që i përgjigjet kushteve të kredisë. Ata gjithashtu duhet të paraqiten në një nga zyrat e noterisë ku dhe të lidhin një kontratë paraprake me shitësin e shtëpisë dhe të bëjnë kërkesë nëpërmjet noterit për certifikatën e pronësisë që kërkojnë të blejnë të rifreskuar. Ndërkohë që vet banka do duhet të përcaktojë një vlerësues pronash të licencuar për të bërë vlerësimin e pronës që kredimarrësi do të blejë. Pas përfundimit të këtyre procedurave, blerësi do të duhet të bëjë te noteri edhe përcaktimin e termave të kontratës së blerjes së shtëpisë dhe përcaktimin e shumës që do të paguajë vetë dhe atë që do të paguajë banka nëpërmjet kredisë. Si rregull shuma që duhet të paguajë vetë blerësi duhet të kapë shumën nga 20 deri në 30 për qind të vlerës së pronës që do të blejë. Ndërkohë që banka do të mbulojë nga 70 deri në 80 për qind të vlerës së saj. Pas dorëzimit të certifikatës së pronësisë së rifreskuar, kontra-



Foto ilustruese

**SHTËPIA**

Përfutuesit duhet të gjejnë edhe apartamentin ose shtëpinë që duan të blejnë dhe që i përgjigjet kushteve të kredisë. Ata, gjithashtu, duhet të paraqiten në një nga zyrat e noterisë ku dhe të lidhin një kontratë paraprake me shitësin e shtëpisë dhe të bëjnë kërkesë nëpërmjet noterit për certifikatën e pronësisë që kërkojnë të blejnë të rifreskuar.

**AFATI**

E gjithë procedura nuk duhet të zgjasë më shumë se gjashtë muaj dhe brenda saj kredimarrësi duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin dhe kushtet që ka banka. Kësaj here bashkia ka ndryshuar disa kriteret për përfutuesit e kredive. Së pari ka ndryshuar moshën e përfutuesve, pasi është marrë në konsideratë fakti që disa përfutues për shkak të moshës së madhe janë penguar në klasifikimin për kredi. Tashmë moshën e çiftit duhet të jetë me moshë totale deri në 70 vjeç. Së dyti, afati subvencionimit të kredisë do të rritet nga 15 në 20 vjeç, duke bërë që kësti mujor për një familje përfutuese të jetë më i ulët dhe më i përballeshëm.

## Kreditë e buta, rritet shuma dhe afati i shlyerjes

**B**ashkia e Tiranës në zbatimin e programit social të strehimit nëpërmjet kredisë së butë ndryshoi disa kriteret për përfutuesit e kredive. Kjo si një refleksion mbi problematikat që u shfaqën gjatë procesit të parë që u zbatua në 2017. Kështu, së pari ka ndryshuar moshën e përfutuesve, pasi është marrë në konsideratë fakti që disa përfutues për shkak të moshës së madhe janë penguar në klasifikimin për kredi. Tashmë moshën e çiftit duhet të jetë me moshë totale deri në 70 vjeç. Kjo me qellim që çifti përfutues i kredisë të ketë mundësi dhe të jetë i aftë për punë për të siguruar të ardhurën për shlyerjen e kredisë deri në fund. Së dyti, afati subvencionimit të kredisë do të rritet nga 15 në 20 vjeç, duke bërë që kësti mujor



**“**

**KRITERET**

Kosha e çiftit duhet të jetë me moshë totale deri në 70 vjeç. Kjo me qellim që çifti përfutues i kredisë të ketë mundësi dhe të jetë i aftë për punë për të siguruar të ardhurën për shlyerjen e kredisë deri në fund. Së dyti, afati subvencionimit të kredisë do të rritet nga 15 në 20 vjeç, duke bërë që kësti mujor për një familje përfutuese të jetë më i ulët dhe më i përballeshëm.

për një familje përfutuese të jetë më i ulët dhe më i përballeshëm. Edhe ky ndryshim erdhi si rrjedhojë e problematikës që u has herën e shkuar ku familjet të ndryshme përfutuese e kishin të pamundur që të përballonin një këst të madh mujor të pagesës së

kredisë. Tashmë me këtë ndryshim kësti do jetë më ulët dhe më i përballeshëm nga aplikuesit. Gjithashtu, ndryshe nga hera tjetër ka ndryshuar edhe shuma e kredisë që përfutojnë fituesit. Nga 36 milionë lekë të vjetër që ishte shuma që për-

fitohej më parë për një familje me 2 deri në 3 persona, tashmë kjo shumë ka shkuar në 44 milionë lekë të vjetër. Kjo rritje i jep mundësi familjeve të reja që sigurojnë një shtëpi më të mirë dhe më të madhe se më parë.

ta paraprake bëhet aktive në momentin që behet kalimi në llogarinë e noterit të pjesës së pambuluar të bankës ose pjesës që paguan vet aplikuesi. Më pas banka bën lidhjen e marrëveshjes për kredinë dhe kalon shumën e lekëve në llog-

arinë e noterit. Pas këtij momenti noterit bën kërkesën në hipotekë për kalimin e pronësisë në emër të blerësit të ri, por e bllokuan në favor të bankës. Nga ky moment fituesi i kredisë mund të marrë në zotërim shtëpinë e re.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

A. PASURIA nr. 281 / 10, e lloji "Ari", zona kadastrale 2631, volumni 18, faqe 15, sipërfaqe 1.000 m2, adresë: Mborje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 2.168.144 Lekë.

B. PASURIA nr. 187 / 20, e lloji "Ari", zona kadastrale 2631, volumni 11, faqe 250, sipërfaqe 1.500 m2, adresë: Mborje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 739.140 Lekë.

Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.01.2019.  
CEL: 068402666 / 069326286.

**Shqipëria pikë kontakti kufitare e përbashkët me Greqinë**

**P**as Kosovës, qeveria shqiptare pritet të ngrejë një pikë të përbashkët kufitare edhe me Greqinë. Bëhet fjalë për një pikë kontakti kufitare të përbashkët mes të dyja vendeve dhe e cila do të ndihmojë në rritjen e bashkëpunimit, por edhe të lehtësimit të procedurave të kalimit të kufirit për shtetasit e të dyja vendeve. Për këtë qëllim mësohet se Ministria e Brendshme dhe ajo e Ekonomisë dhe Financave kanë arritur të finalizojnë projekt marrëveshjen që do të firmoset me shtetin grek në verën e këtij viti. Qëllimi kryesor është ndërtimi i një qendre e cila do të ketë të punësuar shtetas të të dy vendeve, të cilët do të jenë në funksion të shkëmbimit të informacionit dhe procedurave në kufirin mes shtetit helen dhe vendit tonë. Pika e përbashkët do të funksionojë si në lehtësimin e kontrolleve kufitare për qytetarët që kalojnë aty, por edhe për mallrat, të cilat kontrollohen nga doganat. Burimet bëjnë me dije se marrëveshja synon rritjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të drogave dhe kontrabandës. Ky është hapi i dytë që qeveria shqiptare merr për njehësimin e një pike të përbashkët kufitare pas asaj me Kosovën, edhe pse modeli që po ndiqet nuk është i njëjtë. Këtë vit qeveria jonë pritet të miratojë dhe një marrëveshje me Serbinë, e cila ka si qëllim ndihmën për të dy shtetet që të anëtarësohen në Bashkimin Europian.

## PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET NË 2019-ËN

Vendimi: Aplikimi për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 01.01.2018 e në vazhdim

# Pensionet e pleqërisë, sa do të jenë koeficientët e rinj në 2019-ën

*ISSH do të rillogarisë masën e pensioneve, kategoritë që preken*

Voltiza Duro

Që prej një janarit të këtij viti, janë futur në fuqi koeficientët e rinj të indeksimit të pagave, në bazë të së cilëve do të llogariten pensionet për të gjithë ata që përmbushin kriteret e përcaktuara. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot tabelën me koeficientët që do të përllogaritin masën e pensionit për 2019-ën. Në vitin 2018-të, hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, i propozuar fillimisht nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë që preku të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficient më të ulët. Kështu pensionet që janë lidhur e që do të lidhen në vazhdim do të shumëzohen me koeficientin 8,76. Në vitin 2018, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2017, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë të përcaktuar në këtë vendim nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributive të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001. Ky vendim vlen edhe për vitin 2019-të, ku koeficienti do të jetë 1,00, njësoj si në 2018-ën. Ndërkohë pagat nuk mund të jenë më të larta se paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për efekt të pagimit të kontributive të sigurimeve shoqërore në vitin 2018, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. "Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që cak-



### FORMULA

Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indekskohet e del vlerë më e lartë.

### VENDIMI

Në vitin 2018-të, hyri në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, që preku të gjithë pensionistët e dalë në pension nga 1 janari i vitit 2018 e në vazhdim. Ndërkohë Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të bëjë rillogaritjen e masës së pensioneve për të moshuarit që aktualisht kanë dalë në pension por që iu janë llogaritur masat me koeficient më të ulët.

### KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përfshirë edhe këtë datë.

tohen me datë fillimi nga 1.1.2018 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore", nënvizohet në vendimin e qeverisë.

### KOEFICIENTËT

"Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave që koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë

paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2018 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë si në tabelë", theksohet në vendim. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 927, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për koeficientët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e

pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.12.2017, përfshirë edhe këtë datë. Koeficientët e indeksimit janë ata koeficientë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indekset e ndryshimet që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indekskohet sot me një



### KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

Për pagat referuese deri më 1.1.1994 8,76;

▶ Për pagat e vitit 1994	8,76;
▶ Për pagat e vitit 1995	7,05;
▶ Për pagat e vitit 1996	5,47;
▶ Për pagat e vitit 1997	5,47;
▶ Për pagat e vitit 1998	4,57;
▶ Për pagat e vitit 1999	3,71;
▶ Për pagat e vitit 2000	3,38;
▶ Për pagat e vitit 2001	2,89;
▶ Për pagat e vitit 2002	2,67;
▶ Për pagat e vitit 2003	2,39;
▶ Për pagat e vitit 2004	2,17;
▶ Për pagat e vitit 2005	1,97;
▶ Për pagat e vitit 2006	1,79;
▶ Për pagat e vitit 2007	1,71;
▶ Për pagat e vitit 2008	1,51;
▶ Për pagat e vitit 2009	1,39;
▶ Për pagat e vitit 2010	1,33;
▶ Për pagat e vitit 2011	1,28;
▶ Për pagat e vitit 2012	1,23;
▶ Për pagat e vitit 2013	1,18;
▶ Për pagat e vitit 2014	1,18;
▶ Për pagat e vitit 2015	1,02;
▶ Për pagat e vitit 2016	1,02;
▶ Për pagat e vitit 2017	1,00;
▶ Për pagat e vitit 2018	1,00;
▶ Për pagat e vitit 2019	1,00

koeficient. Edhe ky indeks është i përshkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientë respektivë.

### LLOGARITJA

Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur

rrogë më të lartë, por edhe kjo indekskohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni. Kjo është mënyra më e thjeshtë për llogaritjen e pensionit.



Voltiza Duro

Për të përfituar pension pleqërie individit duhet të bazohet te kriteret, moshë dhe vitet e punës me kontribute. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot dokumentacionin që duhet të dorëzojnë të interesuarit që dëshirojnë ta përfitojnë këtë pagesë. Domosdoshmërisht individit duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 10 muaj për gratë e mbi 65 për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH ka akese mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit, e në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individit mendon se ka 40 vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka marrë nga 1 janari i 1994 e deri më sot. Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listëpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individit ka punuar para vitit 1994, shërben librezë e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individit humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepet në dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar. Dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi të fjalë kërkon të pajiset me një dokument të ri ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individit ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore, janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi. Dokumenti, pra librezë e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vlash apo dublikatë librezë. Në momentin kur ka dublikatë të librezës së punës me signaturë ka një "ngërc" e men-

Shembujt konkretë bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagat referuese

# Si do të përlogaritet masa e pensionit të pleqërisë për 2019-ën

## Kriteret dhe dokumentacioni që duhen plotësuar



### PERLLOGARITJA

Formula e përlogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75 kur individit ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar.

### DOKUMENTACION I PASAKTË

Librezë e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vlash apo dublikatë librezë. Punonjësit e ISSH-së duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

### LISTEPAGESAT

Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listëpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individit ka punuar para vitit 1994, shërben librezë e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individit humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute.

### KRITERET DHE LLOGARITJA

#### Kushtet

► Të gjithë ata persona që kanë plotësuar moshën dhe kanë minimumi 15 vite pune me kontribute mund të përfitojnë pension pleqërie.

► Përkatësisht burrat duhet të jenë mbi 65 vjeç, gratë mbi 60 vjeç e 10 muaj në mënyrë që të mund të marrin këtë lloj pagese.

#### Llogaritja

Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë sipas ligjit 104/2014, neni 18 i cili ndryshon nenin 32 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet si më poshtë:

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.
2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social.
3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 (i cili ndryshon nenin 59 të ligjit 7703 datë 11.05.1993).
4. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social."

Për ta pasur sa më të qartë këtë përlogaritje, është e nevojshme të dihet se çfarë përfaqëson pensioni social.

Sipas ligjit 104/2014, pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetas shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër; janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

#### Formula

► PP (Pension i Pleqërisë) = PS (Pension Social)\* (shumëzuar) me vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100\* (shumëzuar) me vite sigurimi\* (shumëzuar) me BV (baza e vlerësuar).

► Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

jëherë duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

### FORMULA E LLOGARITJES

Formula e përlogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75 kur individit ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientët e vet të indeksimit. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e

bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.



Mungojnë një pjesë e fotografive, policia kërkon ndihmë

## 24 më të kërkuarit në Durrës, fotot e veprat penale që kryen

Mes tyre dhe dy femra të dënuara për trafik

Janë 24 vetë më të kërkuarit në qarkun e Durrësit për vepra të ndryshme penale mes të cilave më të shumtat për trafikim të lëndëve narkotike dhe trafikim fëmijësh. Policia e Shtetit ka publikuar listën e personave të shpallur në kërkim, ku mes tyre janë edhe femra, Afërdita Ibrahim e dënuar me 13 vjet burg për trafikim të lëndëve narkotike dhe Klodiana Agim Shkoza dhe dënuar me 15 vjet burg për trafikim femrash. Përmes një postimi në faqen zyrtare të 'Facebook', policia i bën apel qytetarëve të denoncojnë nëse kanë informacione të mundshme në lidhje me vendndodhjen e tyre. "Policia e Shtetit fton cilindo që ka dijeni mbi vendndodhjen e tyre të telefonojë policinë në numrin pa pagesë 112, apo në aplikacionin "Komisariati Dixhital", duke ju garantuar anonimitetin. Ndihmo dhe ti në sigurinë publike", shkruhet krahas listës, ku për një pjesë të mirë të të kërkuarve është



të edhe fotoja përkatëse. Një pjesë e të kërkuarve kanë vendbanim Tiranën, por mes tyre janë edhe shtetas të huaj italianë e amerikanë



dhe ky i fundit është dënuar me 25 vjet burg për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë. Mangësi në njoftimin e policisë është

fakti se mungon një pjesë e fotografive ndërsa të tjerat janë të pa apdetuara dhe nuk mund të identifikohen lehtë me ndryshimet ndër vite.



45-vjeçarja në gjendje të rëndë, dërgohet në Athinë

Shqiptari godet me thikë gruan, shpallet në kërkim nga grekët

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në një familje shqiptare në Greqi. Në Korinth burri shqiptar ka goditur disa herë me thikë bashkëshorten e tij. 45-vjeçarja ka marrë plagë të shumta dhe është dërguar në Athinë për trajtim më të specializuar. Ajo ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Sipas shtypit grek, burri rreth 45 vjeç kishte pritur gruan e tij jashtë një shtëpie ku ajo punon dhe pas debateve të ashpër me të, e qëllon me thikë disa herë. I dyshuari u largua dhe është shpallur në kërkim nga policia. Ndërsa 45-vjeçarja shqiptare fillimisht u dërgua në spitalin e Korinthit dhe më pas u transportua drejt Athinës. Gruaja ndodhet në rrezik për jetën, ndërsa mjekët thonë se 24 orët e ardhshme do të jenë vendimtare për të. Ngjarja dyshohet të ketë ndodhur për motive banale, megjithatë kjo do të zbardhet nga hetimet e policisë greke. Pak ditë më parë, në Korfuz babai shqiptar Aleko Petro (me emër të ndryshuar nga Bardhyl Guri), qëllon për vdekje me shufër hekuri vajzën e tij Anxhelina Petro dhe e varrosi në oborrin e shtëpisë.





## NGJARJA



## E qëlluan me armë dhe e hodhën në lumë, shpëton 25-vjeçari

## E akuzuan se i vodhi kokainën, dy shqiptarët tentojnë të vrasin të riun

Dy shqiptarë janë arrestuar nga policia italiane në Venezia, pasi kanë plagosur me armë zjarri një 25 vjeçar me origjinë sh-

qiptare në tentativë për ta vrarë. Në pranga kanë përfunduar Lefter Disha, 46 vjeç dhe Armiol Gjoka, 32 vjeç, të akuzuar për vrasjen

në tentativë të bashkëkombësit të tyre me iniciale D.E. Mediat vendase shkruajnë se dy shqiptarët e arrestuar, pasi kanë qëlluar

me armë në pjesën e trupit të riun, e kanë futur atë në makinë dhe e kanë hedhur në lumë duke menduar se ka vdekur. 25-vjeçari ka arritur të dalë në breg dhe ka kërkuar ndihmë. Ai është shtruar në spitalin San Dona. Dy shqiptarët akuzonin bashkëkombësin për vjedhjen e kokainës së tyre, por 25-vjeçari ka mohuar se ka lidhje me zhdukjen e saj.

Sekuestrohen 165 kile kanabis sativa edhe në Tepelenë, aksioni

# Heroina në portin e Durrësit, pranga shoferit Bledar Shqarthy

Vlera e drogës 80 mijë euro, si u zbulua...

Kapen 4 kilogramë heroinë në portin e Durrësit. Droga u gjet e fshehur në një kamion që po nisej në Itali dhe u zbulua nga kontrolli që iu bë mjetit. Bledar Shqarthy, shoferi i kamionit është vënë në pranga nga policia ndërsa po merret në pyetje në komisaratin e Durrësit. Heroina kishte vlerë 80 mijë euro dhe tregu që synonin shpërndarësit ishte veriu i Italisë.

## DURRËS

Të dielën pas kontrollit të një kamioni policia kufitare dhe agjentët e antidrogës zbuluan të fshehur një sasi prej 4 kilogramë heroinë. Droga u gjet brenda një çantë që mbahej nga drejtuesi i mjetit i riu Bledar Shqarthy, i cili aktualisht është nën akuzë për trafikim të lëndëve narkotike. Kamioni ku u gjet droga ishte i ngarkuar me konfeksione, por nga informacionet paraprake trafikimi nuk ka lidhje me kompaninë që kishte në pronësi kamionin. Automjeti do të merrte linjën e tragetit Durrës-Ankona e mendohet se heroina ishte destinuar të shpërndahet në veri të Italisë.

## GJIROKASTËR

Një sasi e konsiderueshme kanabisi u sekuestrova nga Policia në Tepelenë ndërsa tre veta u prangosën si përgjegjës të drogës. Nga Specialistët për Hetimin e Trafiqeve dhe Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë pas një pune të mirë organizuar në bashkëpunim me shërbimet e Stacionit të Policisë Memaliaj u bë e mundur ndalimi dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve: E.L., 30 vjeç, banues në Tepelenë; E.L., 24 vjeç, banues në Memaliaj dhe A.B., 39 vjeç, banues në Elbasan. Arrestimi i këtyre shtetasve u bë



Kamioni ku u gjet droga



Shoferi i kamionit Bledar Shqarthy

pasi në aksin rrugor Krahës-Memaliaj gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin me të cilin po udhëtonin, policia gjeti dhe sekuestroi një sasi prej 63.6 gram lëndë e dyshuar narkotike si ajo e llojit kanabis sativa. Gjithashtu gjatë kontrollit në një banesë në fshatin Zhulaj, Memaliaj, që dyshohet se e përdornin shtetasit E.L dhe E.L., Policia gjeti dhe sekuestroi një sasi prej rreth 102 kilogramë lëndë të dyshuar narkotike e llojit kanabis sativa. Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprimet mëtejshme, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve e kryer në bashkëpunim". Parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

**TIRANE.** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën me dije se duke nisur nga sot nuk do kryejë asnjë shërbim për mjetet që kanë errësuar xhamin e përparmë dhe xhamat e parë anësorë. "Nga 7.01.2019 i ndalojmë çdo shërbim automjeteve që kanë errësuar xhamin e përparmë dhe xhamat e parë anësorë! Pa dallim: Shefa, VIP-a, të Fortë! Në bashkëpunim me Task Forcën e Transportit Rrugor dhe Policinë Rrugore po skedojmë dhe do penalizohen edhe "ustallarët" dhe serviset!" - thuhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Gjithashtu, sa i

## DPSHTRR: Nga sot ndalohen shërbimet për makinat me xhama të zinj

## Lehtësira për marrjen e patentës, s'ka ritestim



përket marrjes së patentës, DPSHTRR bën me dije se janë krijuar disa lehtësira. Drejtoria e Transporteve njofton se nuk do ka më ria-

plikim për test teorie nëse e ke marrë atë, por ke ngulur në praktikë dhe anasjelltas. "Jo përsëri pagesa, tarifa e shpenzim kohe nga e para.



## LEHTESIRAT

DPSHTRR bën me dije se janë krijuar disa lehtësira. Drejtoria e Transporteve njofton se nuk do ka më rriplikim për test teorie nëse e ke marrë atë, por ke ngulur në praktikë dhe anasjelltas. "Jo përsëri pagesa, tarifa e shpenzim kohe nga e para.

Do ritestoheh vetëm për testin ku nuk je kalues! Gjithashtu, i tërë procesi i radhës së testeve do informatizohet", thuhet në një njoftim.

## KONTROLLI

Të dielën pas kontrollit të një kamioni policia kufitare dhe agjentët e antidrogës zbuluan të fshehur një sasi prej 4 kilogramë heroinë. Droga u gjet brenda një çantë që mbahej nga drejtuesi i mjetit i riu Bledar Shqarthy, i cili aktualisht është nën akuzë për trafikim të lëndëve narkotike.

## MOTI I KEQ SITUATA

"Lëvizni me kujdes në Qafë Qarri-Ersekë; Kot-Sevaster; Erind-Çajup; Sterblevë-Lunik"

Ditën e djeshme, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka dhënë informacione për gjendjen e rrugëve në të gjithë vendin si pasojë e motit të keq me ngrica dhe temperaturave të ulëta dhe. Sipas ARRSH, të gjitha akset rrugore janë të hapura, por në disa akse rekomandohet përdorimi i zinxhirëve. Gjithashtu, ARRSH rekomandon përdoruesit e rrugës të tregojnë kujdes dhe të respektojnë sinjalistikën rrugore.

### SITUATA NË VEND

Autoriteti Rrugor Shqiptar bën me dije se punonjësit e mirëmbajtjes kanë punuar intensivisht për pastrimin e rrugëve, veçanërisht ato të mbuluara nga akulli. "Në të gjitha akset kryesore të vendit nuk ka pasur probleme me qarkullimin e mjeteve, pavarësisht reshjeve të borës dhe temperaturave shumë të ulëta. Kontraktorët e mirëmbajtjes kanë punuar gjatë natës duke pastruar dhe trajtuar me kripë rrugët, kujdes i veçantë është treguar në zonat me prezencë akulli", thekson Autoriteti Rrugor Shqiptar.

### AKSET PROBLEMATIKE

Autoriteti Rrugor Shqiptar këshillon drejtuesit e automjeteve që të përdorin zinxhirë në disa akse të caktuara dhe të tregojnë kujdes e të respektojnë sinjalistikën rrugore. "Rekomandohet të kalohen me zinxhir rrugët: Qafë Qarri-Ersekë; Kot-Sevaster; Erind-Çajup; Ura e Cerencit-Sterblevë-Lunik; pjesërisht Boboshticë-Dardhë. Rekomandohen përdoruesit e rrugës të tregojnë kujdes dhe të respektojnë sinjalistikën rrugore. Të vendosin zinxhir në akset që përmendëm më sipër, të respektojnë udhëzimet e Policisë së Qarkullimit Rrugor, të lëvizin me shpejtësi të reduktuar dhe të përdorin gomat e dimrit", nënvizohet në njoftimin e ARRSH-së.

# Bora "pushton" Shqipërinë, ARRSH: Ja akset ku duhet të bëni kujdes

"Lëvizni me zinxhirë, respektoni sinjalistikën rrugore"



### LEVIZJA ME ZINXHIR

"Rekomandohet të kalohen me zinxhir rrugët: Qafë Qarri-Ersekë; Kot-Sevaster; Erind-Çajup; Ura e Cerencit-Sterblevë-Lunik; pjesërisht Boboshticë-Dardhë. Rekomandohen përdoruesit e rrugës të tregojnë kujdes dhe të respektojnë sinjalistikën rrugore.

### PUNIMET

Autoriteti Rrugor Shqiptar bën me dije se punonjësit e mirëmbajtjes kanë punuar intensivisht për pastrimin e rrugëve, veçanërisht ato të mbuluara nga akulli. "Në të gjitha akset kryesore të vendit nuk ka pasur probleme me qarkullimin e mjeteve, pavarësisht reshjeve të borës dhe temperaturave shumë të ulëta.

## Ngrijnë tubacionet, 115 familje pa ujë dhe të bllokuar në Dibër

Temperaturat e ulëta dhe ngricat kanë shkaktuar probleme në disa zona të thella të Dibrës. Rreth 115 familje në Ternoven e Madhe dhe në Ternoven e Vogel vijnë të jenë të bllokuara nga dëbora e ditëve të fundit. Gjithashtu, këto familje dhe shumë të tjera vuajnë edhe mungesën e ujit për shkak të ngrirjes së tuba-



cioneve. Temperaturat gjatë natës në Bulqizë kanë shënuar vlerat minimale -14 gradë Celsius.

Kujtojmë se i gjithë vendi është përfshirë nga temperaturat e acarta, ndërsa në Korçë u shënuar edhe viktima i parë, ku një burrë dyshohet se ka vdekur nga i ftohti.



Pamje nga rruget me debore në Shqipëri

## STUDIMET NË TURQI KRITERET

Ja kush mund të kandidojë. Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 17 janarit

# Aplikimi, bursa në Turqi për studentët e Universitetit të Tiranës

*Njihuni me degët ku mund të kandidoni në Bachelor e Master*

Studentët e Universtitetit të Tiranës, tash më kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 17 janar të këtij viti në universitetin Çukurova në Turqi. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 5 muaj, si për nivelin Bachelor ashtu edhe për Masterin e Doktoraturën. Të gjithë studentët e interesuar mund të aplikojnë për degë studimi si: Marrëdhënie Ndërkombëtare; Histori; Matematikë dhe Statistikë; Bioteknologji; si dhe Kimi. Bursat e studimit mbulojnë kompensimin prej 800 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. "Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës." theksohet në njoftimin e Universitetit të Tiranës.

### APLIKIMI NË BACHELOR

Studentët e nivelit Bachelor që janë të interesuar të fitojnë bursën 5 mujore në Universitetin Çukurova në Turqi, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës gjatë aplikimit. Respektivisht, ata duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo turke; një kopje të pasaportës; vërtetim studentit si dhe një listë notash. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një letër motivimi në gjuhën angleze apo turke në varësi të programit të studimit; certifikatën e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Turqisht B1 në varësi të programit të studimit); si dhe të ashtuquajturën "Learning Agreement". "Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit", citohet në njoftim. Studentët duhet të kenë kujdes gjatë aplikimit në universitetin Çukurova në Turqi, të përzgjedhin lëndë të njëjta me ato që do të kryenin në semestrin e parë në fakultetin e Universitetit të



# 800

### EURO NË MUAJ MBULIMI MUJOR

Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 800 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.

# 17

### JANAR, AFATI I FUNDIT

Studentët e Universitetit të Tiranës, tashmë kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 17 janar të këtij viti në Universitetin Çukurova në Turqi. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 5 muaj.

### DOKUMENTACIONI

#### Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën turke/angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke në varësi të programit të studimit);
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/turke në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Turqisht B1 në varësi të programit të studimit);
- \*Learning Agreement; Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:
- CV (në gjuhën angleze/turke);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke në varësi të programit të studimit);
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke në varësi të

- programit të studimit);
- Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke në varësi të programit të studimit);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/turke në varësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Turqisht B1 në varësi të programit të studimit);
- \*Learning Agreement; Dokumentet e nevojshme për aplikim për nivelin Doktoraturë:
- CV (në gjuhën angleze/turke);
- Listë e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke);
- Listë notash doktorature (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke);
- Letër motivimi + Përkthim të temës së kërkimit (në gjuhën angleze/turke në varësi të fushës së mobilitetit);
- Certifikata e gjuhës së huaj niveli B1 (Turqisht/Anglisht sipas programit të studimit)
- \* Learning Agreement

Tiranës, në mënyrë që lëndët dhe kreditet të njihen kur të kthehen. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që studentët do të zhvillojnë në UT gjatë se-

mestrit të parë, atëherë kur të kthehen sërish, studentët duhet të frekuentojnë degë që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. "Ju duhet të përzgjidhni të kryeni

në Universitetin Çukurova në Turqi lëndë të njëjta me ato që do të kryenin në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse

lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillojnë në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të frekuentoni lëndë dhe nuk do të merrni kredite në universitetin pritës, por do të shkoni vetëm për humulzim, atëherë duhet të përcaktoni këtë gjë në dokumentin Learning Agreement", theksohet në njoftim.

### APLIKIMI NË MASTER

Ndërkohë, të gjithë studentët që vazhdojnë studimet master e dëshirojnë që semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 ta kryejnë në universitetin Çukurova në Turqi, duhet të paraqesin dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara. Kështu, kandidatët duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo turke; një kopje të Pasaportës; vërtetim studentit; diplomën e nivelit Bachelor ku duhet t'i bashkëngjitet lista e notave. Gjithashtu, aplikantit duhet të dorëzojë edhe një listë notash të nivelit master të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze apo turke në varësi të programit

të studimit si dhe një letër motivimi e një certifikatë të gjuhës së huaj. Ashtu si në nivelin bachelor, studentët duhet të paraqesin kontratën "Learning Agreement". Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe t'i dërgojnë të skanuara po të njëjtin dokumentacion në emailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

### APLIKIMI NË DOKTORATURË

Të interesuarit për nivelin Doktoraturë duhet të aplikojnë brenda 17 janarit me këtë dokumentacion: CV (në gjuhën angleze/turke); listë e publikimeve; kopje e Pasaportës; vërtetim studentit (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke); listë notash doktorature (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/turke); letër motivimi si dhe një përkthim të temës së kërkimit (në gjuhën angleze/turke në varësi të fushës së mobilitetit); certifikata e gjuhës së huaj niveli B1 (Turqisht/Anglisht sipas programit të studimit) si dhe Learning Agreement.

Viktimat nga Tirana dhe Fieri, si ndodhi ngjarja e rëndë

# Aksident i rëndë në Tepelenë, Vdesin dy vetë, plagosen pesë

TEPELENE

Dy persona kanë humbur jetën dhe 5 janë plagosur gjatë një aksidenti në autostradën Levan-Tepelenë, pranë fshatit Varibob. Një mjet përplasi fillimisht një kalimtar dhe pasagjerët e një autobusi të ndaluar shkuan për t'i dhënë ndihmën e parë të aksidentuarve, por ato janë marrë përpara nga një tjetër automjet që mesa duket nuk ka pasur kohë të ndalonte. Ngjarja e rëndë ndodhi të dielën mbrëma ndërsa drejtuesi i mjetit që përplasi rreth 6 pasagjerë të autobusit u shoqërua në polici. Gazetari i "BalkanWeb", Ervis Kuçi ka raportuar nga vendi i aksidentit se dy persona kanë humbur jetën në vend. Mësohet se drejt vendit të aksidentit janë nisur 5 autoambulanca dhe po kryejnë transportin e të plagosurve drejt Spitalit Rajonal të Fierit.

**POLICIA**

"Në datën 06.01.2019, rreth orës 18:00, në aksin



rrugor Levan-Tepelenë, në vendin e quajtur Varibob, një automjet ka përplatur një këmbësor. Në vendngjarje janë grumbulluar disa banorë të zonës dhe pasagjerë të një mjeti tjetër që kishte parkuar aty për të

dhënë ndihmën e parë personit të aksidentuar, të cilët janë përplasur nga një mjet tjetër tip "Opel" i cili ka hyrë në parakalim. Për pasojë kanë ndërruar jetë shtetasit F.Sh, 64 vjeç, banues në Tiranë dhe D.L, 55 vjeç, banues

në Vjosë, Fier si edhe janë dërguar në Spitalin Rajonal Fier dhe ndodhen nën kujdesin e mjekëve 5 shtetas të tjerë. Po punohet për identifikimin e shtetasve të plagosur dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes", -njofton policia.

**AKSIDENTI  
MË VDEKJE  
NË "URËN  
VAJGURORË"**

Pas ngjarjes së rëndë në aksin Levan-Tepelenë, u shënuar një tjetër aksident në Urën Vajgurore.

Raportohet se një person ka ndërruar jetë në fshatin Çiflik.

Policia dhe grupi hetimor janë nisur drejt vendit të ngjarjes për të përcaktuar shkaqet e aksidentit.

Shqiptarja vret italianin: M'u hodh sipër, më godiste me grushte

Më goditi në kraharor gjatë kohës që i jepja makinës, më pas m'u hodh përsipër dhe më goditi me grusht në fytyrë. U përpoqa të shpëtoja duke kaluar në sediljen e pasme, më pas dola nga makina. Zbriti edhe ai. I kishte pantallonat e ulura. Hipa në makinë dhe e ndeza. E përplasa, por nuk doja ta vrisja. Kisha frikë se mos më përdhunonte". Është ky rrëfimi i shqiptares Aurela Perhati, një 24-vjeçare shqiptare, e cila dy ditë më parë u arrestua për vrasjen e Massimo Garitta, një 53-vjeçar italian, përdorues i lëndëve narkotike. Ngjarja e rëndë ndodhi mbrëmjen e ndërrimit të viteve në fushat jashtë Ovadës, në provincën e Alessandrias, Torino. Pasi e përplasi me makinë e reja u largua nga vendi i ngjarjes, për t'u arrestuar vetëm 2 ditë më parë. Autoritetet policore mbërritën tek 24-vjeçarja pasi gjëten shenjat e marmitës së makinës së saj Lancia Y, në trupin e viktimës. Aurela, e cila sipas mediave fqinje jetonte në Itali prej 22 vjetësh së bashku me familjen, punonte si shitëse. Ajo mësohet se është njohëse e 5 gjuheve të huaja dhe e mirëintegruar në shoqërinë italiane. Avokati i saj, për mediat fqinje tha se e reja është e tronditur nga ngjarja e rëndë dhe se vijon të përsërisë se nuk kishte si qëllim t'i bënte keq askujt. 24-vjeçarja tashmë ndodhet në burg dhe akuzohet për vrasje. Viktima Massimo Garitta ishte i papunë dhe jetonte jo shumë larg zonës ku banonte familja Perhati. Sipas asaj që shkruan Italia "Corriere della Sera", duke qenë në gjendje shoku, Aurela nuk arrin të kujtojë arsyen se përse e mori në makinë Garitta-n. "E njihje, e dinte që ishte banor i zonës", pohoi avokati. "Shpesh ai i kërkonte ndonjë qindarkë, ndonjëherë një cigare. Mesa duket atë ditë i kishte kërkuar që ta shoqëronte deri diku me makinë dhe ajo e kishte marrë, sepse i kishte ardhur keq", shpjegoi ai më tej./



tvklan.al

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS






## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:  
Efektet e  
mrekullueshme  
të verës në  
organizëm

## KESHILLA



Thonjtë  
e futur në mish,  
masat dhe mënyrat  
e trajtimit

## Dr.shk. Rezar Rusi:



Urologu: Kujdes,  
mos e mbani uri-  
nën gjatë, një ndër  
faktorët kryesorë  
të sëmundjes

## Ja si mund të hiqen gurët në vezikën urinare

"Rastet kur duhet kryer  
ndërhyrje kirurgjikale"

• 8 arsyt pse duhet të konsumoni kos çdo ditë. Çaj me lëkurë qepe, ja sëmundjet që parandalon

Urologu: Kujdes, mos e mbani urinën gjatë, një ndër faktorët kryesorë të sëmundjes

# Rezar Rusi:

## Ja si mund të hiqen gurët në vezikën urinare

"Rastet kur duhet kryer ndërhyrje kirurgjikale"

Voltiza Duro

Nrastet kur urina qëndron gjatë në vezikë, mund të kristalizohen kripërat minerale e si pasojë formohen gurë në vezikën urinare. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" mjeku urolog, dr.shk. Rezar Rusi tregon se në momentin që pacientët kanë dhimbje në fund të barkut, urinim të shpeshtë apo me dhimbje, urinim me gjak etj., duhet të paraqiten për vizitë pranë specialistit. Më tej mjeku sqaron të gjithë shkaktarët që ndikojnë në formimin e gurëve vezikalë. Rusi më tej thekson se ka disa raste ku mënyra e vetme e heqjes së gurit është ndërhyrja kirurgjikale si dhe jep disa këshilla për parandalimin e sëmundjes.

### Si formohen gurët e vezikës urinare?

Gurët e vezikës urinare janë masa të forta kripërash minerale, të vendosura në vezikë. Gurët formohen kur urina duke qëndruar gjatë në vezikë, koncentrohet duke bërë të mundur kristalizimin e kripërave minerale. Kjo urinë e ndenjur dhe e koncentruar është shpesh pasojë e pamundësisë për të zbratur tërësisht vezikën.

### Cilat janë simptomat kryesore që shfaqin pacientët e prekur?

Kur shfaqen simptomat ato mund të variojnë nga dhimbja e barkut, deri në prezençën e gjakut në urinë. Gurët e vegjël mund të eliminohen vetë, por të tjerët kanë

nevojë për ndërhyrje. Nëse nuk trajtohen, ato mund të shkaktojnë infeksione dhe komplikacione të tjera. Disa pacientë me gurë të vezikës nuk paraqesin probleme, madje edhe kur kanë gurë të mëdhenj. Por nëse guri irriton murin e vezikës ose bllokon rrjedhjen e urinës, atëherë shfaqen simptoma si dhimbje në fund të barkut; te burrat, dhimbje dhe shqetësime në penis; urinim me dhimbje; urinim i shpeshtë; vështirësi gjatë urinimit ose ndërprerje e tij; gjak në urinë; urinë e turbullt ose më e errët se zakonisht.

### Mund të përmendni disa prej shkaktarëve që ndikojnë në krijimin e këtyre gurëve?

Kushtet më të zakonshme që ndikojnë në formimin e gurëve të vezikës është zmadhimi i gjëndrës së prostatës. Një prostatë e zmadhuar ose hiperplazia beninjë e prostatës, mund të shkaktojë gurë të meshkujt. Si rezultat i zmadhimit, prostata mund të shtypë uretrën dhe të ndërpresë rrjedhjen e urinës, duke bërë që ajo të mbetet në vezikë.

Edhe dëmtimi i nervave (vezikë neurogjene) ndikon pasi nervat marrin mesazhe nga truri dhe ia përcjellin ato muskujve të vezikës duke bërë që ato të shtrëngohen

ose të lëshohen. Nëse këto nerva janë të dëmtuar vezika mund të mos zbrazet plotësisht. Gurët në vezikë mund të formohen kur vezika inflamohet. Ndonjëherë kateterët e vezikës që futen në vezikë nëpërmjet uretrës për të ndihmuar rrjedhjen e urinës, mund të shkaktojnë gurë. Gjithashtu, mund të shkaktojnë gurë mjetet antikonceptive ose stentet që futen në vezikë aksidentalisht. Në sipërfaqen e këtyre mjeteve, depozitohen kripëra minerale të cilat më vonë transformohen në gurë.

### A janë të njëjtë gurët në veshka me ato të vezikës?

Gurët që formohen në veshka s'janë të njëjtë me ato të vezikës. Ato zhvillohen në mënyra të ndryshme dhe shpesh nga shkaqe të ndryshme. Por ndonjëherë, gurët të vegjël të veshkave zbrasin poshtë në vezikën urinare nëpërmjet uretereve dhe nëse nuk dalin jashtë, mund të rriten duke formuar gurë të vezikës.

### Cilat janë moshat më të predispozuar për t'u prekur nga sëmundja?

Në vendet në zhvillim, gurët e vezikës janë të zakonshëm të fëmijët, shpesh për arsye të dehidratimit, infeksionit dhe dietës me pak proteinë. Në vende të tjera të



Dr.shk. Rezar Rusi

botës, ato hasen më shpesh në rritur, sidomos në meshkujt mbi 30 vjeç.

### Cilat janë komplikacionet që mund të sjellë prania e gurëve në vezikë?

Gurët e vezikës që nuk hiqen, edhe nëse s'kanë simptoma, mund të japin komplikacione si: keq-funksionim kronik i vezikës (mund të japin probleme urinare afatgjatë si dhimbje dhe urinim të shpeshtë). Por gurët mund të vendosen në dalje të vezikës, aty ku urina del nga vezika dhe hyn te uretra, duke bllokuar daljen e urinës jashtë trupit. Nderkohë infeksionet urinare të përsëritura mund të shkaktohen nga gurët e vezikës.

### Si bëhet diagnostikimi i sëmundjes?

Kryhet ekzaminim fizik ku mjeku prek pjesën e poshtme të barkut për të parë nëse vezika është e fryrë; në disa raste kontrollon prostatën me gisht nëpërmjet rektumit për të parë nëse ajo është e zmadhuar apo jo.

Pacienti duhet të bëjë edhe analizën e urinës, si dhe ultratinguj (Eko). Për të bërë diagnostikimin mund të përdoret edhe radiografia, pielografia intravenoze; skaner CT spiral (mund të zbulojë dhe gurë shumë të vegjël).

### Cilat janë mënyrat e heqjes së gurëve nga vezika?

Gurët e vezikës, në përgjithësi duhen hequr. Nëse janë të vegjël, rekomandohet përja çdo ditë e sasive të mëdha të ujit për të ndihmuar eliminimin e tyre. Megjithatë, për arsye se gurët e vezikës

shpesh shkaktohen nga pamundësia e zbrazjes plotësisht të vezikës, nxjerrja spontane e tyre është e pamundur. Gurët e vezikës shpesh hiqen me anën e një procedure që quhet cystolitholapaxy. Kjo konsiston në futjen e cistoskopit në vezikë nëpërmjet uretrës për të parë gurin. Për thyerjen e gurëve mund të përdoren pajisje të ndryshme që prodhojnë rreze lazer, ultratinguj, ose që i thyjnë ato mekanikisht.


### Po në rastet e gurëve të mëdhenj si veprohet?

Ndonjëherë gurët janë të mëdhenj ose shumë të fortë për t'u thyer. Në këto raste aplikohet kirurgji e hapur (operacion) për t'u hequr. Hapet vezika dhe hiqet guri.

### Si mund të parandalohet krijimi i gurëve në vezikë?

Zakonisht gurët e vezikës shkaktohen nga disa gjendje patologjike që janë të vështira për t'i parandaluar, por mundësitë e formimit të gurëve të vezikës mund të pakësohen duke ndjekur disa këshilla.

Diagnostikimi i hershëm dhe mjekimi i prostatave të zmadhuara ose problemeve të tjera urologjike, mund të pakësojë rrezikun e formimit të gurëve vezikalë. Edhe pirja e një sasive të madhe lëngjesh sidomos ujit, mund të parandalojë gurët vezikalë për arsye se lëngjet hollojnë koncentrimin e kripërave minerale në vezikën urinare. Sasia e ujit që duhet pirë varet nga mosha, madhësia e trupit, gjendja shëndetësore si dhe niveli i aktivitetit.



Voltiza Duro

Vera është shumë e shëndetshme për organizmin, dhe këshillohet të konsumohet nga moshat e rritura çdo natë një gjysmë gote, qoftë verë e kuqe apo e bardhë. Vera ndihmon në qarkullimin e gjakut dhe forcon sistemin imunitar pasi përmban antioksidantë që ndihmojnë në fuqizimin e organizmit. Vera e kuqe apo e bardhë ndihmon në një zemër të shëndetshme. Duke ulur tensionin e gjakut, dhe duke ofruar efekte qetësuese, vera ndihmon në qetësimin e shplohshjen e muskujve kardiakë, kështu ul rrezikun e goditjes në zemër dhe në tru. Tensioni i lartë është shkaktar i shumë problemeve në zemër dhe në tru, por vera ndihmon në qetësimin e përgjithshëm dhe ul tensionin, gjithashtu ul edhe ndjesinë e mërztjes apo të lodhjes. Prandaj është shumë e këshillueshme të konsumohet 1 gotë në darkë pasi iu ndihmon të qetësoheni pas një dite të lodhshme, ruan trurin dhe zemrën tuaj nga ndonjë lëvizje tensioni. Ndërkohë që konsumimi i saj në darkë ju ndihmon për një gjumë të qetë.

#### Përbërësit e verës

Të gjithë e dimë që vera vjen nga rrushi, megjithëse shumë fruta të tjera mund të bëhen verë. Kjo e fundit përmban fenole me shumicë të cilat ndihmojnë në uljen e tensionit, uljen e kolesterolit në gjak, dhe kanë efekte të hollojnë gjakun. Ngjyra e kuqe e verës i takon cianineve, ndërsa shija që ka vera varet nga oksidimi I Fenoleve, dhe madhësia e tyre. Sa më të vogla të jenë fenolet aq më shumë e hidhur shijon vera. Përmban procianidina, të cilat, gjithashtu, hollojnë gjakun, por ka edhe taninë, të cilat mund t'i japin pak hidhërim, por ato shërbejnë si konservantë për verën, duke ndaluar rritjen e baktereve të ndryshme. Këto janë përbërësit kimikë në sasi më të mëdha, ndërsa në sasi të vogla janë edhe përbërës inorganikë si: metale, nitrate, etj.

#### Përgatitja e Eliksirit

Marrim 2 shishe verë të kuqe dhe i hedhim në një tenxhere. Shitjme në të 2-3 copa ananas, pak xhinxher (nëse ju pëlqen që vera të ketë pak si shije djegëse), 2-3 shkopinj me kanellë, 6-7 copa karafil. Ngrohet përzjerja derisa të arrijë temperaturë 100 gradë celsius. I hidhen 3 lugë gjelle sheqer ose mjaltë. Hiqet menjëherë nga soba para se të fillojë të valojë. Në fund shtohet lëngu i



Mjeku popullor: Si të kuroni gripin dimëror me pluhurin çudibërës

## Merja: Efektet e mrekullueshme të verës në organizëm

*"Frenon rrezikun e goditjeve në zemër dhe tru"*



Mjeku popullor  
Vili Merja

një kokrrë portokalli. Vera është gati për t'u konsumuar.

#### Pluhuri kundër gripit

Nëse i referohemi një bime të njohur botërisht si shtarë e zezë apo rrënja e sanzës do të shikojmë efektet e saj çudibërëse kundër gripit. Shija e saj është shumë e hidhur por ka rezultate të mrekullueshme brenda një kohe të shkurtër në kurimin e gripit dimëror. Ky pluhur mund të hidhet në gojë dhe ta shoqërosh me ujë apo ta hedhësh në kos e ndikon në forcimin e

rruazave të bardha të gjakut, pra leukociteve si dhe grimcat që kanë hyrë në organizëm i bllokun dhe nuk i lejon që virusi të krijojë lidhje me qelizën. Kjo bimë ka një mori lëndësh kimike, rreth 10-12 të tilla që japin efekte pozitive jo vetëm në sistemin imunitar të organizmit, por ndihmojnë dhe përmirësojnë shumë funksionimin e mëlçisë. Gjithashtu mund të përdoret edhe te fëmijët anemikë, pasi qelizat absorbojnë hekurin, pra është një bimë e mrekullueshme që përmirëson edhe oreksin. Kjo bimë pavarësisht



efekteve, nuk është shumë e njohur në vendin tonë. Një vlerë shumë të rëndësishme ka edhe çaji i trëndë-

filiti të egër, i cili ndikon në kurimin e gripit. Në këtë periudhë përballimi me uljen e temperaturave në ambientet e jashtë dhe mbajtjen në vlera të larta të temperaturës në shtëpi. Pikërisht këto ndryshime temperaturash pëlqen edhe virusi i gripit, qoftë ai A, B apo C. Më të shpeshtit janë virusi A dhe B që përhapen me rrugë ajrore nga njëri person te tjetri nëpërmjet teshtimave, prekjës së objekteve të përbashkëta, ose kollitja në ambientet publike. Këto janë mënyrat e përhapjes së gripit që me rrugët aspiratore hundë apo gojë, arrijnë në brendësi të alveolave të mushkërive, më pas hyjnë në kombinacion me to. Mbështjellja proteinike e viruseve, ngjiten në alveolën e mushkërive, hyjnë në bashkëpunim me qelizën e fillojnë ta shkatërrojnë. Kjo periudhë inkubacioni që zgjat 24-72 orë shoqërohet me çrregullime fiziologjike, këputje trupore, rrjedhje hundësh, skuqje sysh etj. ky është momenti që njeriu duhet të kuptojë që virusi është i pranishëm në trupin e tij dhe pas 1-2 ditësh bëhet si një burim amplifikacioni e përhapet edhe te të tjerët. Ndërsa në trupin e të sëmurit fillon ajo "lufta" e brendshme fiziologjike e organizmit e i gjithë ky cikël zgjat 5, 7 apo 10 ditë. Por, nëse marrim masa mbrojtëse, ky cikël do të shkurtohet e shkalla e agresivitetit të

# Thonjtë e futur në mish, masat dhe mënyrat e trajtimit

Nëse ju shkurtoni thonjtë shumë të shkurtër, veçanërisht në anët e gishtave të mëdhenj të këmbëve, ju mund të përgatitni terrenin që thotë të hyjë në mish. Ashtu si shumë njerëz, kur ju shkurtoni thonjtë nëse prisni dhe pjesët anësore atëherë thonjtë përkulen, harkohen dhe marrin formën e gishtave. Por kjo teknikë mund të inkurajojë rritjen e thoit nën lëkurën e gishtit tuaj. Anët e prera të thoit fillojnë e inkorporohen, gërmohen nën lëkurën. Një thua i hyrë në mish gjithashtu mund të ndodhë në qoftë se ju i vishni këpucë që janë shumë të ngushta apo shumë të shkurtra.

## Simptomat

Kur ju ndodh hyrja e thoit nën mish, mund të japi vëshirësi, ënjtje dhe ndjeshmëri. Më vonë, ajo mund të skuqet dhe të infektohet, madje jep edhe dhimbje. Thoi i hyrë në mish është një gjë e zakonshme dhe veçanërisht e dhimbshme tek të rinjtë. Hyrja e thoit nën mish haset më shpesh në gishtin e madh. Hyrja e thoit nën mish ndodh kur lëkura në njërin apo të dyja anët e thoit rritet mbi skajet e tij, ose kur thoni vetë rritet nën lëkurë. Skuqje, dhimbje dhe ënjtje në cep të thoit mund të rezultojë dhe infeksioni mund të pasojë së shpejti. Ndonjëherë një sasi e vogël qelbi mund të shihet duke rrjedhur nga zona e prekur. Hyrja e thoit nën mish zhvillohet për shumë arsye. Disa raste janë kongjenitale (të lindura)-thoi është shumë i madh për gishtin. Trauma, të tilla si shtypja e gishtit ose shkelja në të, mund të shkaktojë hyrje të thoit nën mish. Megjithatë, shkaku më i zakonshëm është veshja e këpucëve të shtrenguara ose prerja e shkurtuar e thonjve.

## Trajtimi jokirurgjikal

Hyrja e thoit nën mish duhet të trajtohet sa më shpejt që të evidentohet. Nëse kapet që në fillim (para se të infektohet), kujdesi në shtëpi mund të parandalojë nevojën për trajtim të mëtejshëm. Masat që duhet të merrni:

-Futeni këmbën në ujë të ngrohtë 3-4 herë në ditë.

-Mbani këmbët e thata



gjatë pjesës tjetër të ditës.

-Vishni këpucë të rehatshme e të përshtatshme për këmbën dhe gishtërinjtë. Merrni në konsider-

ate veshjen e sandaleve derisa mos të ketë shenja inflamacioni.

-Ju mund të merrni ibuprofen ose acetaminophen për lehtësimin

e dhimbjes.

-Nëse nuk ka përmirësim në 2-3 ditë, ose nëse përkeqësohet gjendja, kontaktoni me mjekun tuaj.



-Ju mund të keni nevojë të ngri-  
ni cepin e thoit lart nga pozicioni i  
saj ngulitur dhe futur nën mish  
dhe të vendosni disa fije pambuk  
në mes të thoit dhe lëkurës. Ndër-  
rojeni këtë paketim çdo ditë.

## Trajtimi kirurgjikal

Nëse ka tepër shenja inflama-  
cioni: ënjtje, dhimbje dhe rrjedhje  
sekrecionesh të pranishme,  
ndoshta thoi është i infektuar  
dhe duhet të trajtohet nga një  
mjek. Ju mund të keni nevojë për  
të marrë antibiotikë nga goja dhe  
thoni mund të ketë nevojë të hiqet  
pjesërisht ose tërësisht. Mjeku  
mund të heqë kirurgjikalisht një  
pjesë të thoit, një pjesë e shtratit  
të tij, disa prej indeve të buta ngji-  
tur me të dhe madje edhe një pjesë  
e qendrës së rritjes. Kirurgjia  
është efektive në eliminimin e  
buzës së thoit nga rritje brenda  
dhe përpara lëkurës. Heqja e  
përhershme e thoit mund të  
këshillohet për fëmijët me hyrje  
të thoit nën mish me infeksione  
të përsëritura e kronike. Nëse ju  
keni shumë dhimbje dhe / ose in-  
feksion, mjeku juaj mund të lar-  
gojë një pjesë të thoit të hyrë nën  
mish (shkëputje e pjesshme e  
thoit). Në gishtin tuaj do injekto-  
het anestetik dhe mjeku do për-  
dorë gërsërë për të prerë pjesën  
hyrëse nën mish duke u kujdesur  
që të mos prek shtratin e thoit.  
Një ekspozim i shtratit të thoit  
mund të jetë shumë i dhimbshëm.  
Heqja e tërë thoit të hyrë nën  
mish (shkëputje të plotë e shtratit  
të thoit) rrit gjasat që thoi që do  
rritet do dali i deformuar. Mund  
të marrë 3-4 muaj rirritja e thoit.

## Faktorët e rrisht

Nëse problemi nuk është  
kongjenital, mënyra më e mirë për  
të parandaluar hyrjen e thoit në  
mish, është mbrojtja e këmbëve  
nga traumat dhe veshja e këpucëve  
dhe çorapeve që të jenë të përsh-  
tatshme e rehatshme për gish-  
tërinjtë. Thonjtë duhen prerë drejt  
me një makinë prerëse të pastër,  
nuk duhen prerë cepat apo qoshet  
e thonjve. Shkurtoni thonjtë jo më  
pak se buza e gishtit. Mbani këmbët  
të pastra dhe të thata gjatë  
gjithë kohës.



# Këshilla

## 9 arsyeet pse duhet të konsumoni kos çdo ditë

**K**osi është një produkt i mrekullueshëm për tu konsumuar si nga të rriturit edhe fëmijët. Ai prodhohet nga fermentimi i qumështit dhe është i pasur me proteina, kalcium, vitaminë B6, B12 dhe probiotikë.

Më poshtë po listojmë disa prej arsyeve kryesore se pse duhet të hani kos çdo ditë.

### I bën mirë stomakut

Kulturat e gjalla tek kosi janë efikase kundër konstipacionit, diarresë, inflamacionit të zorrëve, kancerit të zorrës së trashë e të tjerë. Këto probiotikë përforcojnë imunitetin dhe mbrojnë stomakun nga infeksionet.

### Osteoporozë

Brishtësia e kockave vjen si pasojë e ndryshimeve hormonale dhe mungesës së vitaminave D dhe kalciumit. Kosi është i pasur me kalcium dhe konsumimi i rregullt i tij përmirëson strukturën e kockave.

### Tensionin i gjakut

Studimet kanë konfirmuar se produktet e bulmetit kanë aftësinë të rregullojnë tensionin e gjakut.



Me sasinë e duhur të produkteve me pak yndyrë, rreziku i tensionit të lartë të gjakut bie me 50 përqind.

### Pesha

Kosi është ideal për të kufizuar kaloritë. Ai shuan urinë dhe nepsin për ushqime të ëmbla. Pasi përthithet, kalciumi nga kosi ndikon që qelizat e yndyrës të ulin prodhimin e kortizolit ndërkohë që amino acidet djegin yndyrën e tepërt. Rekomandimet gjithnjë vlejné për kosin me pak yndyrë.

### Skuqjet e lëkurës të bebës

Ky ushqim është ideal për lëkurën e ndjeshme të bebeve. Atë mund ta përdorni për të trajtuar skuqjet në lëkurë të shkaktuara nga pelenat.

### Vitaminat

Kosi përmban fosfor, kalium, jod, zink, vitaminë B5 dhe B12. Kjo e fundit është një vitaminë shumë e rëndësishme për rruazat e kuqe të gjakut dhe sistemin nervor.

### E ftohura

Kur imuniteti është i fortë, do të mund të mposhtë viruset ose bakteret. Konsumoni 150-200 gramë kos në ditë për t'i shpëtuar simptomave të të ftohurës, gripit dhe problemeve me fytyrë. Ky produkt përgjysmon shanset e shfaqjes së këtyre sëmundjeve.

### Shëndeti i lëkurës

Kosi është një nga kurat më të mira për femrat. Ai përmirëson lëkurën, shtrëngon porët dhe i jep lëkurës elasticitet dhe shkëlqim.

Kosi është i dobishëm kundër simptomave të plakjes, ankthi më i keq për shumë femra.

### Shëndeti i flokëve

Kosi është i dobishëm edhe kundër flokëve të thatë dhe të hollë. Ai forcon çdo qime të flokut dhe pastron skalpin nga zbokthi. Sigurisht që kosi duhet të jetë nga ai që përgatit me farë dhe jo i përpunuar.



## Çaj me lëkurë qepe, ja sëmundjet që parandalon

**S**htresa e jashtme e lëkurës së qepës përmban sasi të mëdha antioksidantësh që promovojnë mirëqenien e përgjithshme të organizmit dhe e mbrojnë atë nga sëmundjet. Lëkura e qepës fuqizon aftësitë vetë-shëruese të trupit madje mund të mbrojë edhe nga disa forma të sëmundjeve tumorale. Ajo përmban fibër të tretshme dhe flavonoidë që promovojnë elasticitetin e lëkurës duke ju dhuruar një paraqitje të re dhe pa akne. Studimet konfirmojnë se shtresa e jashtme e qepës është shumë e pasur me flavonoidë dhe kuercetinë, dy flavonoidë të rëndësishëm dhe antioksidantë që luftojnë inflamacionin. Kuercetina lufton radikalet e lira në gjak dhe inflamacionin, ul stresin oksidues që shkakton sëmundje si ateroskleroza, sëmundje të zemrës, infeksione të prostatës, ulçerë në stomak, diabet dhe problemet me syrin. Lëkura e qepës funksionon edhe kundër alergjive, azmës dhe simptomave të tyre. Çaji i lëkurave të qepës ndihmon gjithashtu në alkalizimin e peshashit të sistemit tretës dhe pastrimin e zorrës së trashë. Shkencëtarët po studiojnë rolin e kuercetinës në uljen e kolesterolit në gjak dhe tensionit të gjakut por edhe inflamacionin. Për më tepër, ata besojnë se lëkura e qepës përmirëson rritjen e muskujve, parandalon disa lloje të sëmundjeve të rënda dhe trajton depresionin.

Lëkura ngjyrë kafe dhe shtresat e jashtme të qepës përmbajnë shumë fibër, flavonoidë dhe antioksidantë, por edhe vitaminat A, C dhe E që mbrojnë qelizat e kuqe nga radikalet e lira. Lëkura e qepës e mban lëkurën më të re dhe përmirëson funksionet e trupit. Kuercetina te lëkura e qepës ul tensionin e gjakut dhe parandalon bllokimin e arterieve. Ngrënia e qepës ul rrezikun e sëmundjeve të zemrës; tumoreve të zorrës së trashë; mbipeshës; diabetit të tipit 2; problemeve gastrointestinale. Lëkura e qepës lufton qelizat kancerogjene, mykun, bakteret dhe shërben si antioksidant. Lëkura e qepës është detoksifikuese dhe mund të konsumohet si çaj. Për të përgatitur këtë të fundit fillimisht qëroni qepën dhe lëkurat vendosini në një kavanoz; mbusheni me ujë dhe lëreni kavanozin në frigorifer për 12 orë. Në këtë mënyrë lëkurat do të lëshojnë ushqyesit në ujë. Kullojeni lëngun dhe shtoni mjalhtë. Këshillohet që ky çaj të pihet para gjumit.



### Marrëveshja e Prespës, Merkel viziton Athinën në janar

## Zëvendës/zëdhënësja e qeverisë gjermane: Berlioni do të mbështesë mbylljen e kontestit

Ditën e enjte dhe të premte që vjen, Kancelarja gjermane Angela Merkel do të qëndrojë për vizitë në Greqi. Është parashikuar që Merkel të takohet me kryeministrin grek Aleksis Cipras, ndërsa do të pritë edhe nga presidenti i Greqisë, Prokopis Pavlopoulos. Merkel do të realizojë takim edhe me liderin e Demokracisë së Re, Kirjakos Micotakis. Zëv-



#### AXHENDA

Merkel do të realizojë takim edhe me liderin e Demokracisë së Re, Kirjakos Micotakis. Zëvendës zëdhënësja e qeverisë gjermane Martina Fric paralajmëroi se në axhendën e bisedimeve do të jenë marrëdhëniet bilaterale dhe çështjet evropiane dhe ndërkombëtare.

endës zëdhënësja e qeverisë gjermane Martina Fric paralajmëroi se në axhendën e bisedimeve do të jenë marrëdhëniet bilaterale dhe çështjet evropiane dhe ndërkombëtare. Mediat greke thonë se edhe Marrëveshja e Prespës do të jetë njëra prej temave për të cilat do të bisedojë Merkel me kryesinë e shtetit, ndërsa Fric, sipas ANA-MPA, e pyetur për atë nëse edhe marrëveshja do të jetë në axhendë, e ka theksuar mbështetjen e Berlinit për mbylljen e kontestit mes dy vendeve.

Mustafa: Momenti historik që Presheva t'i bashkohet kosovarëve

# RTK: Serbia po përgatit shkaktimin e trazirave në vend

Përiudhën e tanishme, Kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafa, e cilëson si kohën e duhur që të ndodhë bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën. Duke folur për gazetën zvicerane, 'Le Temps', Mustafa ka thënë se marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë duhet të sigurojë zhvillim ekonomik dhe integrim të shqiptarëve, mirëpo sipas tij një gjë e tillë është vështirë e arritshme. "Marrëveshjet e paqes që u arritën tentuan sigurimin e paqes, zhvillimit ekonomik, dhe integrimin politik të shqiptarëve, mirëpo asnjëra nga këto nuk erdhi", thotë ai. Në një situatë të tillë, shton ai, tani është koha që Presheva të bashkohet me Kosovën. "Sot ne kemi shansin historike që të bashkohemi me Kosovën", thotë ai. Megjithatë, Mustafa është skeptik se Beogradi do të lëshojë pe për të gjithë Luginën e Preshevës, territor ky me rëndësi strategjike për Serbinë. Ideja e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën ishte vënë fillimisht në tavolinë nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi në atë që ai e quante korrigjim të kufirit. Ideja në fjalë nuk e ka gjetur përkrahjen e opozitës, të cilët vazhdimisht kanë konsideruar se kjo nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se shkëmbim territore. Ndërkaq presidenti serb, Aleksandër Vučić ka marrë pjesë në edicionin festiv të krish- tindinjëve 'Kurira'. Vučić foli edhe për kompromisin në dialogun me Kosovën me Serbinë. "Kompromisi në politikë nuk është një humbje, por një fitore"-u shpreh ai. Presidenti serb vazhdoi duke thënë se e di

Vučić: Kompromisi fitore, Kosova s'duhet të mbetet pa serbë



Kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafa

**RAGMI MUSTAFA:**  
"Marrëveshjet e paqes që u arritën tentuan sigurimin e paqes, zhvillimit ekonomik, dhe integrimin politik të shqiptarëve, mirëpo asnjëra nga këto nuk erdhi. Sot ne kemi shansin historik që të bashkohemi me Kosovën", tha ai.

që serbët nuk do ta pranojnë këtë, por pati një mesazh për ta. "E them këtë, edhe pse e di që serbët nuk do ta pranojnë. Nuk do ta pranojnë sepse është më lehtë të jetosh në mitë dhe lavdërime sesa në realitet. Ne duhet të ndry-

shojmë shumë"- vazhdoi Vučić. Në fjalim kritikoi ata që mbështesin një konflikt të ngrirë me Kosovën. Ai tregoi se cili është qëllimi dhe detyra e tij në Kosovë. "Detyra jonë është të parandalojmë që Kosova të mbetet pa serbë",

u shpreh ai. Nga ana tjetër, sipas burimeve të RTK, organet shtetërore të Serbisë kanë përgatitur shkaktimin e incidenteve në Kosovë. Njëpër një organet e saj, Beogradi ka përgatitur incidente në mesin e komunitetit serb, me qëllim fajësimin e shqiptarëve dhe destabilizimin e rajonit. Sipas burimeve të RTK, e gjithë kjo vjen pas alarmit në Serbi për shkak të votimit në Kuvend për formimin e ushtrisë së Kosovës. Shërbimet sekrete serbe, sipas RTK, kanë shtuar përpjekjet për shkaktimin e incidenteve në Kosovë, pas formimit të ushtrisë së Kosovës. Këtë e vërteton edhe fakti i komunikimit

**ALEKSANDËR VUČIĆ:**  
"Kompromisi në politikë nuk është një humbje, por një fitore. E them këtë, edhe pse e di që serbët nuk do ta pranojnë. Nuk do ta pranojnë, sepse është më lehtë të jetosh në mitë dhe lavdërime sesa në realitet. Ne duhet të ndryshojmë shumë. Detyra jonë është të parandalojmë që Kosova të mbetet pa serbë", u shpreh Vučić.

të një zyrtari serb të strukturave të sigurisë me familjen e tij, ku iu ka thënë që të mos dalin në vende ku ka shumë njerëz, sepse shpejt mund të ndodhë një rast i ngjashëm si ai 'Panda' para disa vjetëve, ku u vranë disa të rinj serbë. Sipas burimeve të televizionit publik, ky plan i Serbisë për destabilizimin e rajonit është dekonspiruar nga organet e sigurisë në Kosovë. Serbia ka reaguar e acaruar pas formimit të ushtrisë së Kosovës. Deklaratat shkuan aq larg se kryeministrja serbe, Ana Brnabić, tha se Serbia mund ta bëjë gati ushtrinë për ndërhyrje në Kosovë nëse Kosova formon ushtrinë.

#### SHKURT

### Ngricat polare përfshijnë Greqinë, humbin jetën 3 persona

Jo vetëm Shqipëria, por pjesa më e madhe e Evropës është përfshirë nga moti i keq me reshje bore dhe temperatura të ulëta. Tre persona vdiqën në Greqi si pasojë e të ftohtit ekstrem që po përjeton vendi. Tre persona, dy burra dhe një grua të cilët ndodheshin në makinë në momentin kur u përfshinë nga përmbytjet në afërsi të Athinës. Gruaja u gjet e vdekur nga i ftohti në makinë ditën e shtunë, ndërsa të dielën u gjetën trupat e dy burrave të përfshirë nga uji. Greqia po përballlet me një valë të zgjatur të të ftohtit ekstrem, me temperatura që zbesin në zona të caktuara deri në -18 gradë Celsius dhe shumë rajone janë mbuluar nga dëbora.

### Protestojnë gjakovarët kundër pelegrinëve serbë

Në Gjakovë qytetarët protestuan sot për të kundërshtuar ardhjen e pelegrinëve serbë. Qytetarët thonë se nuk janë kundër ritualeve të tyre fetare, por se në mesin e tyre ka prej atyre që ata i njohin bëmat e tyre gjatë kohës së luftës. Protesta nisi para Kishës Ortodokse, por pelegrinët serbët nuk dihet nëse do të mbërrijnë ditën e sotme. Qytetarët mbanin në duar pankarta me mesazhe për të afërmit e tyre që nuk janë gjetur si dhe për krimet serbe që u kryen në këtë qytet gjatë kohës së luftës.

### Vijon opozita serbe, s'ndalen protestat kundër Vučićit

Opozita serbe nuk po i ndal protestat kundër Presidentit Aleksandër Vučić në Beograd. Dhjetëra mijëra njerëz marshuan në bulevardet në qendër të kryeqytetit serb, për të pestën javë radhazi, duke kërkuar dorëheqjen e Presidentit të cilin e akuzojnë për vendosjen e diktaturës. Edhe këtë herë slogani mbizotërues ishte "një nga 5 milionë" si kundërpërgjigje ndaj deklaratës së Vučićit se nuk do t'ua linte partive opozitare pushtetin edhe sikur 5 nga 7 milionë banorët e Serbisë të dilnin në protesta. Të tjera parulla akuzonin presidentin për shtypje të opozitës pas dhunës ndaj një prej liderëve Borko Stefanović, por edhe të mediave. Në protestë ishin përfshirë edhe nostalgjikë të ish-Jugosllavisë. Prej zgjedhjeve të 2016-ës, Vučić ka një shumicë të konsoliduar në parlament, ndaj dhe ka sfiduar opozitën me zgjedhje të parakohshme ku sondazhet tregojnë se mbështetet nga më shumë se 53 % e votuesve.

Në botë ka "Trump të vegjël" që profilizojnë veten në ndjekjen e axhendave të pazakonta

# Viti 2019, pesë surprizat e mëdha që e presin Europën

Ulja e interesit të Bankës Qendrore Europiane, ja ç'prietet të ndodhë

**U**në dyshoj se ne të gjithë do të zbu lojmë në vitin 2019, se në botë ekzistojnë gjithnjë e më shumë "Trump të vegjël" - liderë politikë që duan ta profilizojnë veten përmes ndjekjes së axhendave të pazakonta. Por kjo nuk është diçka e habitshme. Ja çfarë mendoj se mund të ndodhë në skenën evropiane dhe globale në vitin që sapo ka hyrë:

**SURPRIZA NR.1: NGA MBRETËRIA E BASHKUAR**

Me kaosin e Brexit gjithnjë në rritje, në Britaninë e Madhe po fillon të dominojë zhgënjimi. Duket e qartë se njerëzit po mendojnë tashmë, se dalja nga unioni nuk ishte një veprim dhe aq i mençur. Qeveria e zonjës Mej do të zbulojë planin e saj të zhvilluar fshehurazi, projektin e krijimit të një "alternative të BE-së" (AEU). Për këtë, kryeministrja britanike është në bisedime me vendet e Evropës Veriore dhe me Irlandën për një bashkëpunim më të ngushtë. Brukseli zyrtar "nuk është i kënaqur" për këtë. Ndërkohë qeveria gjermane ndihet e tunduar. Ajo ndjen se AEU mund të jetë një alternativë edhe për të, në rast se Francës i merren këmbët, dhe kur motorët e tjerë të BE-së mund të jenë më të përshatshëm për të udhëhequr zonën jugore (euro) të BE-së.

**SURPRIZA NR.2: NGA ITALIA**

Qeveria populiste në Romë, po e pranon më në fund se populli italian nuk dëshiron të largohet nga



euro - apo nga BE. Çfarë duhet bërë në rrethana të tilla? Një revolucioni i ri, që më në fund ta nxjerrë vendin nga mjerimi i stërzgatur ekonomik dhe politik, do të kërkonte një reduktim radikal të borxhit publik. Sapo të arrihet kjo, bankat italiane do të jenë sërish në gjendje shumë më të mirë. Do të plotësohen të gjithë Kriteret e Mastroiitit mbi borxhin. Qeveria mund të investojë sërish, dhe të kryejë rishpërndarjen e dëshiruar ngalart poshtë. Së fundmi, Italia është befas shteti model në eurozonë, gjë që ka shqetësuar shumë prej anëtarëve të tjerë, veçanërisht ata të Europës Veriore.

**SURPRIZA NR.3: NGA GJERMANIA**

Në Gjermani, Partia So-

cialdemokrate (SPD), po i dorëzohet më në fund të pashmangshmes. Duke e ditur se CDU është mjaft e patundur në mbështetjen që gëzon tek votuesit e qendrës, një bashkim me Partinë e Majtë është duke u menduar seriozisht. Për këtë qëllim, nisën të mbahen bisedime të sinqerta. Pastaj, vjen një njoftim befasues. Duke pasur parasysh sesa pak sukses politik pati zgjedhja e Andrea Nahles si udhëheqësja e parë femër e një SPD dikur të lavdishme, SPD-ja e rimëruar (Die Linke ishte një ndarje nga partia mëmë në vitin 2007) në një grua si udhëheqëse e një partie të ri-bashkuar. Sahra Vagenknecht, do të bëhet drejtuesja e re e partisë. Gjatë vitit, jo më pak për

shkak të qëndrimit kufizues të presidentit të ri për migracionin, formacioni i ri politik do të arrijë të tërheqë pjesë të konsiderueshme të votuesve të AfD-së. Në mënyrë intriguese, ai do të tërheqë njëkohësisht votuesit e partive të gjelbra, që janë të zhgënjyer në të Gjelbrit, që po rëshqasin shumë në të djathtë.

**SURPRIZA NR.4: NGA BANKA QENDRORE EUROPIANE**

Banka Qendrore Europiane, rikthehet me guxim në skenë. Në përgjigje të ankesave nga biznesi dhe bankat, ajo po e trajton dobësinë e përgjithshme të ekonomisë evropiane, duke paralajmëruar çuditërisht se do të ulë normat e interesit në zero në pranverën e vitit 2019. Kjo

do të çojë fillimisht në një tronditje të madhe për tregjet financiare, pasi shumë investitorë do të kapen të papërgatitur. Por sapo pjesëmarrësit e tregut, t'kuptojnë se kjo është më e mira për monedhën euro dhe për veten e tyre në një periudhë afatgjatë, humori i tregjeve do të rikthehet. Çmimet e aksioneve në bursat e Evropës, do të rriten sërish.

**SURPRIZA NR.5: UDHËHEQËSI I RI I EVROPËS**

Pas një beteje të ashpër midis kandidatëve të partive më të mëdha, në prag të zgjedhjeve të Parlamentit Evropian në maj 2019, kërret e shteteve dhe qeverive evropiane do të vendosin t'i thonë "jo" secilit prej tyre. Në vend të kësaj, ata do të zgjedhin Kristin Lagard si presidentin e ri të Komisionit Evropian, deri

atëherë drejtuesja e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Pasi u përzgjedh si gruaja e parë që drejtoi FMN-në, që nga fillimi i institucionit në vitin 1944, zonja Lagard do të regjistrojë një rekord dytë, duke u bërë presidentja e parë e Komisionit Evropian që nga themelimi i unionit më 1957. Duke e ditur se kjo është një lëvizje e vonuar, Parlamenti Evropian do të përtypë sërish krenarinë e tij, pasi do të zëvendësohet si mekanizmi kryesor përzgjedhës për udhëheqësin e Komisionit Evropian. Lagard njofton se Komisioni i saj i ri, do të përqendrohet veçanërisht në promovimin e demokracisë në të gjitha nivelet e qeverisjes në të gjithë Evropën. Ky argumenton ajo, është ilaçi më e mirë politik për të ndalur një rritje të mëtejshme të nacionalizmit populist, dhe zhgënjimin e qytetarëve me politikën.



**Dy vite mbret, sulltani Muhammed V heq dorë nga fronti**

**S**ulltani Muhammed V, pas dy vitesh në fron, ska vendosur të heqë dorë përfundimisht si nga sundimi i Malajzisë. Mbreti kishte njoftuar zyrtarisht sundimtarët malajzianë për abdikimin e tij nëpërmjet një letre. Sulltani Muhammed V ka shprehur mirënjohjen e tij ndaj sundimtarëve vendas, të cilët e zgjedhën atë si mbretin e 15-të Yang Di-Pertuan Agong më 13 dhjetor 2016. Kontrolluesi i familjes mbretërore Datuk Ean Ahmad Dahlan Ab. Aziz tha se mbreti ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i tij në përputhje me nenin 32 (3) të Kushtetutës Federale. "Gjatë qëndrimit të tij si Yang Di-Pertuan Agong, Madhëria e Tij punoi për të përmbushur përgjegjësitë e tij dhe besimin e vendosur si kreu i shtetit, duke shërbyer si shtylla e stabilitetit, burimi i drejtësisë dhe si një ombrellë e solidaritetit dhe unitetit njerëzve", tha Wan Ahmad Dahlan. Wan Ahmed tha se mbreti, gjatë kohës së tij në detyrë, është përpjekur të përmbushë përgjegjësitë e tij si shef i shtetit dhe ka luajtur një rol si një rol rregullues në stabilitet dhe si burim i drejtësisë.

## Vrasja e truporjës në Londër, shqiptarët autorë të vrasjes?

**N**jë truporjë që humbi jetën mbrëmjen e Vitit të Ri në Londër, besohet të jetë vrasë nga shqiptarët. Daily Mail, duke iu referuar burimeve policore, raporton se 33-vjeçari Tudos Simionov është viktimë e përlshjes mes bandave. Autorët, që besohet të jenë gangsterë shqiptarë, kishin shkuar në festën me "drita të kuqe" që zhvillohej në një shtëpi për të zhvatur para nga tutorët, prostitutat dhe trafikantët e drogës që ndodheshin aty. Gjithçka që ndodhi ishte një betejë mes bandave ri-



vale, pasi shqiptarët po mundohen të marrin kontrollin e sa më shumë zonave në Londër. Truporja i festës

mbeti i vrarë me thikë në gjoks nga përlshjet. Festa me "drita të kuqe" besohet se ishte organizuar nga Eddie

Davenport 53 vjeç. Në vitin 2011 ai ishte dënuar me 8 vite burgim për mashtrim me vlerë 4.5 milionë Paund. Për autoritetet britanike, Davenport njihet si personi që u bë i njohur duke organizuar festa orgjish për nxënësit e familjeve të pasura. Avokati i tij thotë se 53-vjeçari nuk ishte organizator i kësaj feste, ku mbeti i vrarë truporja nga Rumania. Por, nuk konfirmoi as nëse ishte i pranishëm apo jo në këtë party që zhvillohej në shtëpinë e tij.

Opinion

i Ditës

# Shkëlqimi dhe rënia e protestave studentore

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

...për të dalë në demonstratë. Këmbëngulja disaditore dhe masiviteti i protestës fitoi zëmrat e shumë qytetarëve dhe analistëve të cilët u rrekën që të glorifikonin apo romantizinin këtë protestë duke bërë paralelizma edhe me studentët e dhjetorit të vitit 1990. Parullat simpatike kreative të hedhura të karakterizuara nga ironia e mprehtë si dhe qytetaria e vetëpërmbytjes me të cilën u zhvilluan, i dhanë një imazh akoma më të pranueshëm për qytetarët. Tek shumë u krijua një iluzion se më në fund shqetësimet për varfërinë, emigracionin masiv, korrupsionin, kriminalizimin e të tjera probleme tërëse në vendin tonë, po gjenin një zë dinjitoz të fuqishëm përfaqësues tek protestat e studentëve. Po ashtu shumë opozitarë e kritikë të qeverisë fërkuan duart me shpresën se "patatet e nxehta" të sulmeve ndaj qeverisë do i nxirrnin me duart e studentëve.

Shfaqja e këtyre protestave në ditët e para krijoi një tronditje tek Partia Socialiste dhe lideri i saj, që kishte bindjen se ishte në modë dhe me ekzibicionizmin dhe ekstravagancën e tij gëzonte pëlqimin e brezave të rinj. Po ashtu të mësuar me një opozitë goxha të mështë e pa ndonjë epërsi të madhe morali, kjo protestë erdhi si një dush i ftohtë i paparshikuar prej mazhorancës. Aktivizmi studentor në vetvete është një lajm i mirë për shëndetin e demokracisë, sepse lë të kuptohet se brezat që po vijnë nuk kanë për të ngelur indiferentë apo cinikë në politikë. E drejta e fjalës, e të bashkuarit dhe e medias janë shtylla të kushtetutës sonë e për rrjedhojë e drejta për të protestuar është e ligjshme e legjitime. Po ashtu vënia në pikëpyetje e qeverisë, kërkimi i llogarisë, ngritja e zërit pa patur frikë nga ndëshkimi janë parime themelore të demokracisë dhe protestat e studentëve në njëfarë mënyre shërbyen si ripërtëritje të frymës demokratike.

Janë të shumta rastet historike ku aktivizmi studentor solli një impakt të rëndësishëm për gjithë shoqërinë. Kështu për shembull protestat pacifiste në SHBA kundër luftës së Vietnamit gjatë viteve 1966-69 u bënë pothuaj ekskluzivisht në kampuset universitare. Mes tyre pikati Universitetit Shtetëror i Kentit ku u vranë katër studentë në përleshje e sipër me policinë. Lufta kundër apartheidit në Afrikën e Jugut pati kulmin e vetë në 1976 kur mbi 20000 studentët e Sowetos u përballën me një polici mizore e cila vrau 176 prej tyre duke ndërkombëtarizuar çështjen e apartheidit dhe nxituri reagim të rreptë brenda dhe jashtë vendit. Protesta më e famshme studentore është ajo e sheshit të Tiananmenit në Pekin në vitin 1989 që ishte shkëndija e parë e



fuqishme për demokraci në Kinë. Po ashtu një marshim i qetë i studentëve të Pragës në 17 Nëntor 1989 me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Studentëve, u shndërrua në një ortek me mbi gjysmë milionë qytetarë të drejtuar prej Havelit që çoi drejt lëshimit të pushtetit prej partisë komuniste duke fituar emrin Revolucionit i Purpurt. Protestat e fundit studentore që kanë bërë bujë kanë qenë ato në SHBA për çështje të diskriminimit racor si dhe për kufizimin e përdorimit të armëve. Pra, ka një pritshmëri të arsyeshme që protestat studentore t'i shërbejnë gjithë shoqërisë e jo vetëm studentëve.

Mirëpo shumë shpejt këto shpresa filluan të veniten sidomos kur protestuesit deklaroheshin në mënyrë naive se nuk merrreshin me politikë (nuk ka protestë apolitike kur target është qeveria). Pra një ndër zhgënjimet kryesore që u prek nga opinioni i gjerë publik ishte mungesa e kërkesave konkrete politike që të sintetizojn apo mishëronin shqetësimet e mbarë shoqërisë për realitetin. Kur kërkesat që u paraqitën ishin të kufizuara tek interesat materiale të studentëve ose disa kërkesa tashmë të përfollura shumë herë këta protestues filluan të ngjanin si "rebelë pa kauzë". Nga lokomotivë të ndryshimeve shoqërisë studentët u shpërfaqën tek shumë të tjerë si një grup interesi që lobonte për leverdi të vetë, si të ishin minatorë që donin rritje të rrogës apo bujë që donin shtim të subvencioneve. Për shumë qytetarë fillimisht entuziastë si unë, ditët që vijuan të protestës dhe mungesa e mesazheve të qarta politike apo të programit ideor, lanë përsh-

tyipjen e manifestimit të një frustrimi të moshës dhe aq. Ngjashëm me protestën absurde për armët kimike e cila mori përmasat e historisë kolektive masive dhe mandej u shfry si tullubace pa ndonjë reflektim kur amerikanët vendosën t'i zbërthenin vetë atë arsenal kimik në një anije në ujërat ndërkombëtare të Mesdheut. Pra, ka probabilitet të madh të katandisjet si protesta naive për armët kimike, duke u shndërruar në "shumë zhurmë për asgjë".

Është qesharake të thuhet që kërkesat e studentëve protestues janë jo-politike, sepse jo vetëm mjeti i zgjedhur por edhe përmbajtja e tyre është kryekëput politik duke nisur nga ajo për anulimin e ligjit për Arsimin e Lartë. Kur analizohet lista me 8 kërkesa mund të thuhet se shqetësimet janë legjitime, mirëpo disa kërkesa janë naive e disa të tjera qartazi ideologjikisht të majta të tejkaluara. Shtimi i peshës së vendim-marrjes së studentëve në 50% është pa precedent edhe për universitetet më të majta të Evropës. Garantimi i transparencës me buxhetin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është një detyrim ligjor prej kohësh, nuk ka kuptim përse të jetë ndërhyrje ad-hoc nga kryeministri për ta garantuar. Po ashtu nuk ka kuptim që të thuhet se nuk do kthehemi në bankat e shkollës pa u përmbyhur kërkesat kur dihet që pika 4 rishikimi i titujve shkencorë, 7 i ndërtimit të një biblioteke me standarde evropiane, 8 e performancës në mësimdhënie janë procese që kërkojnë vite pune deri në realizim. Pajisja e studentëve me "Kartë Studenti" është diçka tashmë e tejkaluar dhe shtuar

sepse është detyrim i sanksionuar ligjor që para një dekade mirëpo nuk ka ndonjë vlerë kushedi kryesisht sepse sektori privat nuk ka ndonjë interes të japi zbritjet, ndërkohë që shërbimet e sektorit publik, si bileta për muze e shfaqje, janë goxha të kufizuara. Po ashtu rritja e buxhetit për arsimin është diçka e vjetër që kur kërkohej nga Lëvizja Mjaft qëmoti në ditët e saj të para. Në Shqipëri është dëshmuar se edhe kur janë rritur pagat e pedagogëve nuk është rritur cilësia e arsimit, përkundrazi, pra arsimi kërkon zgjidhje më të ndërlukuara e gjithëpërfshirëse sesa një shkop magjik të thjeshtë si rritja buxhetit. Është padyshim mirë që të shtohet buxheti për arsimin, mirëpo historia e tranzicionit shqiptar ka dëshmuar se më shumë para nuk përkthehet detyrimisht në më shumë cilësi por në më shumë abuzim.

Gjithsesi kryeministri shumë herë e ka pranuar se kërkesat janë të drejta dhe është zotuar se do t'i zgjidhë ato kërkesa. Qeveria ka reaguar, është angazhuar e ka ndërmarrë disa veprime për t'i përmbyhur pjesën më të mëdha të kërkesave e madje është ndryshuar edhe ministria e arsimit. Për sa kohë nuk ka ndonjë qëllim tjetër apo të ardhme të qartë për lëvizjen studentore, një aspekt i rëndësishëm i çdo proteste, ajo nuk ka përse të vazhdojë. Me bllokimin e rrugëve dhe me vazhdimin e kërkesa të njëjta që u adresohen, studentët thjeshtë do bezdisin qytetarët me trafikun e rënduar. Pa kërkesa apo program të qartë politik dhe pa një lider të qartë, protesta është e destinuar që gradualisht të zhduket vetë. Këtë gjë e pamë më së miri

me lëvizjen 'occupy wall street' e cila u ndez e u fik shpejtë si një flakë kashte. Rënia e shkëlqimit të protestës e pamë ditëve të fundit të protestës kur numri i të pranishme ishte dukshëm më i vogël se i ditëve të para dhe se e vetmja gjë që i bashkonte masivisht studentët ishte vendimi për mos të shkuar në mësim.

Mënyra se si evoluoii protesta mandej e kthehu situatën në favor të qeverisë në ditët që pasuan. Protesta e studentëve me kërkesat e saja shumë të kufizuara e teknike por me një bujë e mbulim mediatik të jashtëzakonshëm, edhe drejtuar kundër qeverisë, në njëfarë mënyre mund të thuhet se kanë qenë të dobishme për qeverinë. Së pari, me bujën e tyre të madhe ato eklipsuan një protestë më legjitime e më të drejtë sikurse është ajo e banorëve të Astirit. Po ashtu zhurma e studentëve la në hije skandalet e jashtëzakonshme të njëpasnjëshme të aferës së tenderimit për ndërtimin e asaj rruge kontraversale. Po ashtu mund të thuhet se nga ana e komunikimit, protestat janë menaxhuar e spinuar me mjeshhtëri të rrallë nga kryeministri, i cili e projektoi veten si lider i përgjegjshëm që dëgjon shqetësimet e të qeverisurve dhe vihet menjëherë në veprim për të zgjidhur problemet e parashtruara. Ai ia doli që ta portretizojë në sytë e publikut protestën si një verdikt mosbesimi ndaj opozitës, sepse po të kishte një opozitë dinjitoze s'do të kishte nevojë për protestë apolitike. Jo vetëm aq, por e shfrytëzoi këtë protest si një sepep për të rifreskuar kuadrin e qeverisë duke bërë ndryshime drastike në kompozimin e kabinetit të qeverisë ku më në sy bie mosha e ministrave të rinj si një lloj përpjekje për të ndërtuar një urë lidhje me protestuesit.

Një tjetër problem me këtë protestë është mungesa e krijimit të një udhëheqësie të mirëfilltë të studentëve. Protesta po i ngjan gjithnjë e më shumë një turme pa kokë, ku janë të shumtë palët që orvaten ta shtien në dorë apo të flasin në emër të sajë. Protestat në përgjithësi janë momente ideale historike për të nxjerrë në pah të rinjtë të talentuar, që kanë karizëm e kurajo e që ia dalin të dëshmojnë lidhshmëri duke artikulluar më së miri kërkesat e protestuesve dhe që fitojnë besimin e tyre. Deri më sot ende nuk janë vënë re përfaqësues të spikatur nga ana e studentëve të cilët jo vetëm të flasin në emër të protestës pa ia vënë kush në pikëpyetje atë që thonë por edhe që iu ecën llafi me protestuesit të cilët i ndjekin ata me përkushtim. Një prurje me figura të reja premtuese studentësh të pakomprometuar do të kishte një dobi të madhe për shoqërinë pasi do i jepte një freski moralit të elitës politike shqiptare. Dihet që përveç ndryshimeve në qeverisje apo opinion publik, protestat studentore kanë sjellë edhe figura politike me peshë për vitet e mëpasshme.

Kështu për shembull Azem Hajdari nga student i dhjetorit u bë lideri i parë i partisë së parë opozitare të Shqipërisë ndërsa Hashim Thaçi e ka nisur angazhimin politik në kuadrin të protestave studentore duke u bërë përkortor i studentëve të Universitetit të Prishtinës në 1991. E njëjta

Dje në "Europa e lirë"

# A e fitoi Kosova luftën kundër korrupsionit?

Nga Artion Konushevci

(vijon nga faqja 1)

...raportet e organizatave joqeveritare, gjatë vitit 2018 janë shënuar disa rezultate, por beteja në këtë fushë, sipas tyre, mbetet ende e pa fituar.

Rezultatet e para të luftimit të korrupsionit gjatë vitit 2018, besohet se mund të ndërlihen edhe me kriterin që Bashkimi Evropian u kishte vënë institucioneve të Kosovës, që të dëshmojnë rezultate konkrete të luftimit të kësaj dukurie, për të përparuar në procesin e liberalizimit të vizave. Si rezultat, BE-ja kishte njohur përparimet në luftimin e korrupsionit, por megjithatë nuk liberalizoi vizat për qytetarët e Kosovës.

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli tha për Radion Evropa e Lirë, agjencia të cilën e drejton edhe në vitin 2018 ka trajtuar një numër të madh të rasteve të dyshuara për korrupsion e konflikt të interesit.

"Në nivel vendi nuk jemi të kënaqur sa i takon luftës kundër korrupsionit dhe pse ka pasur disa zhvillime pozitive, sepse të gjitha raportet, edhe ato ndërkombëtare dhe vendore, tregojnë se Kosova ka shënuar një progres të vogël sa i takon luftës kundër korrupsionit. Ka një numër të madh të aktakuzave që janë procese gjyqësore, megjithatë nëse bëhet një vlerësim, nuk jemi të kënaqur mjaft me punën që është bërë, përkundër disa zhvillimeve pozitive që janë në të gjitha nivelet sa i takon kësaj dukurie", tha Havolli.

Bazuar në të dhënat e gjykatave dhe prokurorisë, gjatë vitit 2018 janë shqyrtuar më shumë se 500 raste të dyshuara si raste korrupsioni.

Drejtoresha ekzekutive e organizatës "Fol", Mexhide Demolli, thotë se megjithatë edhe vitit 2018 ka dëshmuar se lufta kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar mbeti e pa fituar.

Ajo thotë se shoqëria civile vazhdimisht vë në dukje se korrupsioni po e bilokon përparimin e Kosovës, po sjellë zhvillim të padrejtë dhe të pabarabartë në shoqëri.

Siç thotë ajo, kjo dukuri po ushqen krimin e organizuar dhe kriminelët, duke e dëmtuar kështu imazhin e vendit në arenën



ndërkombëtare.

"Korrupsioni në Kosovë më nuk është çështje perceptsi, porse është shndërruar në mendësi politike gjithandëj në institucionet publike tash e disa vite. Ende kemi mijëra lëndë të korrupsionit që trajtohen nga prokuroria dhe gjykatat, ndërsa proceset vazhdojnë të zvarriten me vite të tëra. Mbi 90 për qind e personave të akuzuar për korrupsion janë zyrtarë publikë, shifër kjo e cila flet edhe për natyrën e korrupsionit dhe për faktin se sa e korruptuar është e gjithë administrata shtetërore", tha Demolli.

Demolli përmendi faktin se në qeverinë aktuale tash më janë gjashtë ministra që janë me aktakuzë për korrupsion.

"Qeveria në asnjë rrethanë nuk do të duhet të lejojë që të ketë ministra ose deputetë që e kalojnë një pjesë të kohës në salla të gjykatave, duke u përballur me akuzë për korrupsion, e pjesën tjetër të kohës duke marrë vendime në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të tyre si ministër apo deputetë. Nga këto më sipër, rezultat se mobilizimi i shoqërisë kundrejt korrupsionit më nuk është çështje pritjeje, por

immediate. Jo në nivel deklarimi, por me veprime konkrete që çojnë në zbatimin e ligjit dhe denoncimin e çfarëdo tentative të tillë", tha Demolli.

Kurse Betim Musliu nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha se korrupsioni i nivelit të lartë në Kosovë vazhdon të mbetet sfidë dhe fenomen që po shkatërron demokracinë dhe po pengon zhvillimin ekonomik në vend.

"Përdërsia ende nuk e kemi një profil të lartë, i cili është i dënuar me burgim efektiv qoftë edhe një ditë për korrupsion, konsiderojmë se në tërësi përpjekjet për ta luftuar korrupsionin e nivelit të lartë janë të dështuara. Nuk mund të gëzohet askush me akte procedurale të ngritje të aktakuzave ndaj profilit të lartë, përderisa ato nuk provohen në gjykata, pra, nuk kemi dënime përfundimtare me burgim efektiv. Fakti që këto aktakuzave po dështojnë vazhdimisht dhe dëshmon që këto aktakuzave po ngriten qëllimisht me prova dhe dëshmi të mangëta ose po ngriten për t'i persekutuar ose për t'i amnistuar përjetësisht këta zyrtarë të lartë", tha Musliu.

Musliu, tha për Radion Evropa

e Lirë se profili i rasteve të korrupsionit që ndiqen në Kosovë, është profil i ulët dhe rrallë herë i profilit të lartë.

"Bazuar në monitorimin sistematik të Institutit të Kosovës për Drejtësi, rezultat se ende asnjë zyrtar i profilit të lartë nuk është i dënuar me burgim efektiv për vepra penale të korrupsionit. Duke qenë se nuk ka ndjekje të profilit të lartë, dhe ndikimet politike në emërimin e pozitave të larta janë vazhdimisht prezent, atëherë kjo luftë nuk mund të zhvillohet pa pasur njerëz me integritet", tha Musliu.

Krahaz zyrtarëve në Bruksel, edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës, në veçanti sistemit të drejtësisë në vend, që të fuqizojnë luftën kundër korrupsionit.

Ishin ambasadat e vendeve perëndimore në Prishtinë që në vazhdimësi organizuan gjatë gjithë vitit debate, tryeza e diskutime për rëndësinë që ka për një vend si Kosova që po synon të bëhet pjesë e familjes së integruar evropiane, luftimi i krimi dhe korrupsionit.

gjë mund të thuhet për Albin Kurtin që fitoi popullaritetin fillimisht duke qenë në protestat e studentëve të Prishtinës në 1997. Daniel Cohn-Bendit për shembull ka qenë një ndër liderët kryesorë të protestave të famshme të studentëve francezë të majit 1968 dhe sot është president i grupit të Gjelbërve Evropiane - Aleanca e Lirë Evropiane në Parlamentin Evropian. Joschka Fischer, ish-ministri i Jashtëm gjerman, ka qenë po ashtu

tu një ndër drejtuesit e lëvizjes studentore gjermane të vitit 1968. Alexi Tsipras e ka nisur karrierën politike si zëdhënës i lëvizjeve studentore komuniste në Greqi. Pra, ka një histori të gjatë me raste shqiptare e të huaja kur protestat studentore kanë shërbyer si trampolinë për të farkëtuar liderë politikë me peshë.

Studentët protestues kanë premtuar se do të rikthehen nëpër rrugë, por pa bërë të qartë nëse do

të kenë kërkesa të reja apo nëse do të përshkallëzojnë e zgjerojnë protestën. Për momentin mesazhet që po përcillen prej tyre tingëllojnë thjeshtë si vargjet e tekstit të asaj këngës së dikurshme "na llogarisni edhe ne". Përpjes kësaj opinioni publik njëh një vetëm personazhe e shoqata që kanë dalë në mbështetje të protestuesve, por nuk është prezantuar ende me një lidhë të qartë të dalë prej studentëve. Pra, ende nuk ka një përfaqësi që të flasë apo

negociojë në emër të tyre gjë që hedh hije dyshimi dhe ndez konspiracionin se kush qëndron prapa këtyre protestave. Kjo situatë amullie e anarkie e kësaj proteste do të sjellë në mënyrë të pashmangshme në rënien e mbështetjes për të, në një lloj velje edhe të mediave për t'i mbuluar përdërsia nuk sjellin diçka të re dhe për rrjedhojë, në çuarjen dëm të gjithë atyre pritsshmërie dhe shpresave që mbollën në ditët e para të tyre.

## HOROSKOPI

### DASHI

Respekti është diçka që ju duhet t'ua jepni njerëzve të tjerë automatikisht. Ata që thonë se të tjerët duhet ta fitojnë respektin janë dritëshkurter. Dikush në punë mund të testojë pjekurin tuaj.

### DEMI

Një vizitor nga jashtë qytetit do ta gjallërojë rutinën tuaj të përditshme. Sot do të mund të ndiheni energjik dhe kreativ. Kjo është një ditë e mrekulueshme për të provuar diçka të re.

### BINJAKET

Dikush i cili herë pas here është shfaqur si një person i cili sjell komfort dhe ngushëllim në jetën tuaj, sot do të dëshmojë se nuk është ai ose ajo që duket. Për fat të mirë, keni investuar pak të ky person dhe do ta korrigoni lehtë gabimin.

### GAFORJA

Nëse gjërat nuk shkojnë normalisht për ju dhe për dikë në jetën tuaj sot, mos e humbni shpresën. Kjo nuk është një shenjë e sigurt se fundi është afër. Bëhet fjalë për një përplasje kalimtare.

### LUANI

Mundësia për të gjetur një copëz të përafërt në një miqësi të gjatë nuk është larg. Përdërsia ju mund të komunikoni me sinqeritet dhe të respektoni njëri-tjetrin sa duhet, gjërat do të shkojnë mirë. Mos e humbni kohën në pakënaqësi të pakuptimta.

### VIRGJERESHA

Shkëmbimi i ideve do t'ju sjellë gëzim sot. Ju keni disa mendime të mëdha në kokën tuaj ndaj kushtojni vëmendje atyre! Idetë e mëdha duhet të cilrohen. Ky është akti përfundimtar i respektit vetjak.

### PESHORJA

Sot ju do të vlerësoni thellësisht bukurinë e gjërave që askush tjetër nuk arrin të dallojë. Ka ardhur momenti për të krijuar një lidhje afatgjatë e cila do të sjellë shumë gëzim në jetën sentimentale.

### AKREPI

Nuk do të bëhet shumë përparim në ndonjë nga projektet tuaja të tanishme. Kjo pauzë në të vërtetë është diçka ju negative për ju. Është një mundësi për ju që të punoni në zhvillimin e dërrimit.

### SHIGJETARI

Aftësia juaj për të frymëzuar besimin tek njerëzit e tjerë është tani në një nivel të lartë. Kreditibiliteti juaj do të ketë rritje. Shfrytëzojeni këtë moment për të realizuar investime të rëndësishme.

### BRICJAPI

Karriera juaj nuk kërkon vetëm që të vendosni të gjithë kohën dhe energjinë tuaj gjatë kohës që jeni në punë. Ju duhet të shkoni më larg që të keni sukses në pozitën tuaj. Nuk e keni kuptuar nivelin e përgjegjësisë që ju është dhënë.

### UJORI

Dikush që ka frikë nga një përvojë e re, do të vendosë frenat në diçka që mendoni se mund të sjellë më të vërtetë kënaqësi. Në dashuri veprooni ashtu si jua ndjen zemra, sepse nuk do të gaboni.

### PESHQIT

Shumë mundësi do t'ju prezantohen sot, duke ju vënë në dilemë se cilën duhet të zgjidhni. Me financa duhet të tregoni më shumë kujdes ndërsa në dashuri gjërat do të jenë më të lehta.

**Habit ish-trajneri i Shqipërisë**

**De Biasi: Refuzova Palermon se isha në një shpellë...**

Xhani de Biasi ka folur për një intervistë në mediat italiane ku ka treguar refuzimet që ai ka bërë dhe ofertat që ka "hedhur poshtë" pasi i kanë kërkuar që të marrin rolin e numrit një të pankinës. Për ish-

teknikun e Kombëtares Shqiptare, i cili është qajtur edhe hero, sepse arriti që të çonte për herë të parë Shqipërinë në finale të një kompeticioni madhor, siç ishte "Euro 2016" në

Francë, interesohen më shumë ekupe që synojnë mbijetesën. Ndër to është edhe ekipi i Palermos, ku vetë tekniku italian ka qenë futbollist për 3 vite në karrierën e tij. Ai është

kontaktuar nga Mauricio Zamparini që i kërkonte për të marrë drejtimin e ekipit të Palermos, jo një herë, por plot tri herë. Për "Corriere dello Sport", tekniku italian ka thënë:

"Më tha se do të ishte sjellje e edukuar nëse do të përgjigjesha menjëherë, por isha për drekë në një shpellë. Nuk e telefonova menjëherë pasi më është dashur një natë që ta mendoja. Mëngjesin e nesërm, i komunikova që nuk ma ndjente. Mbeteshin edhe 4 ndeshje për t'u luajtur dhe nuk mund ta ndihmoja, përndryshe do të shkoja me vrap atje",- rrëfen De Biasi.



**Igli Tare kërkon të sjellë Malkom te Lacio**

Sulmuesi anësor brazilian, Malkom është pranë kalimit te Lacio. Në verën e shkuar, në adresë të tij mbërritën disa oferta tunde, madje, ai gjeti akordin dhe duhet që të përfundonte te Roma, por ndërroi mendje para se të hipte në avion dhe u bë pjesë e Barcelonës. Aktualisht, sulmuesin brazilian ka oferta edhe nga Kina, por vetë Malkom dëshiron të mbetet në Europë, ndaj edhe në lojë ka hyrë ish-sulmuesi i përfaqësues sonë, Igli Tare, i cili po negocion me brazilianin. Drejtori Sportiv i bardhekaltërve ka marrëdhënie të mira me drejtuesit e Barçës dhe u ka kërkuar atyre huazimin e Malkom deri në fund të sezonit, me të drejtë blerjeje më pas në verën e ardhshme. Vetë spanjollët preferojnë një shitje të menjëhershme në Kinë, por duke parë dëshirën e lojtarit për të mbetur në Europë, po mendojnë seriozisht bashkëpunimin me Lacion.

Partizani është shtatë pikë larg, por për vlonjatën kjo distancë është më se e rikuperueshme



Lojtari më i mirë i Skënderbeut në pjesën e parë të sezonit dhe golashënuesi më i mirë i kampionëve në fuqi. 5 muajt e Dejvi Bregut me fanellën e bardhekuqe nuk kanë bërë asgjë tjetër vetëm se kanë konfirmuar talentin që zotëron 23-vjeçari. Në fakt, të qenit vlonjat është diçka e veçantë edhe për faktin se e kanë në karakter të vlerësojnë tej mase aspektin personal, megjithatë në rastin e Bregut është krenjt e kundërta, grupi ka shumë më shumë rëndësi. "Do ta gjykoja mirë këtë periudhë në aspektin personal, edhe pse kam kërkuar gjithmonë më shumë nga vetja. Rëndësi ka kolektivi. Me erdhi keq që e mbyllëm vitin në këtë mënyrë, edhe pse e nisëm mirë. Besoj se do të rikthehem i shpejt aty ku na takon."

**Bregu: Më kënaq vetëm titulli kampion**

*Sulmuesi vlerëson figurat e Radas, Muzakës e Vangjelit*



është se po kërkoj të jem lider, sepse ky rol u shkon më shumë lojtarëve me eksperiencë si Radas, Vangje-

li apo Muzaka. Ne të tjerët vijmë nga pas. Këta janë shembujt që duhet të ndjekim për të qenë të suk-

sesshëm". Përforcimet janë gjithnjë të mirëpritura dhe nga kjo linjë nuk del as sulmue-

si i Skënderbeut. "Përforcimet i kërkojnë klubi dhe trajneri, nuk jam unë ai që mund të jap mendim se ku dhe si duhet të përforcohemi. Sigurisht që përforcimet gjithmonë janë të nevojshme në një skuadër".

Diferenca prej 7 pikësh me Partizanin kryesues e ka ndërlikuar garën e Skënderbeut, megjithatë synimi i 23-vjeçarit nuk ka ndryshuar aspak. "Nuk jam i kënaqur me pjesëmarrjen në Europë, unë kërkoj titullin dhe besoj se i gjithë klubi dëshiron ta fitojë trofeun e kampionit". Skënderbeu është skuadra e tretë në karrierën e Dejvi Bregut. Ka fituar vetëm një Kupë me Flamurtarin, për më shumë jo si protagonist. Është pak për një prej futbollistëve më cilësorë në Kategorinë Superiore.


**Arjen Roben, Interi kërkon një tjetër "gjysh"**

Interi duket se ka marrë një drejtim tjetër që nga momenti kur në klub është emëruar si administrator Bepe Marota. Ish-drejtuesi i Juventusit po ndjek me interes situatën e futbollistëve me eksperiencë, me të cilët beson se mund të përforcojë radhët e klubit në sezonin e ardhshëm për t'u munduar të ngushtojë distancën me bardheziçtë. Pasi përfitet prej ditësh se zikaltërit kanë një akord parimor me Diego Godin, në radhët e tyre mund të vijë po përsëri në verë një tjetër emër i njohur me shumë eksperiencë në arenën ndërkombëtare, një lojtar të cilin Interi e kërkonte prej një dekade, Arjen Roben. Sipas mediave italiane, përfaqësuesit e lojtarit 35-vjeçar, ua kanë ofruar futbollistin holandez zikaltërve, duke i bërë të qartë se do të ishte një destinacion i preferuar në verë, kur atij i përfundojë kontrata me Bajern Mynih. Interi ka mbajtur "shënimet" e rastit, pasi pavarësisht moshës së holandezit, klasi i tij është i padiskutueshëm dhe mbretet një lojtar, i cili mund të bëjë diferencën në Itali apo në arenën ndërkombëtare.

**Do të zëvendësonte Pepen**

**Beshiktashi dëshiron Berat Gjimshitin**

Berat Gjimshiti ka tërhequr interesin e një prej klubeve më të mëdha turke, Beshiktashit, i cili kërkon përforcime për pjesën e dytë të sezonit pasi nga ai janë "arratisur" me kuptimin e plotë të fjalës disa prej futbollistëve kryesorë. Kriza ekonomike që ka mbërthyer klubin turk ka sjellë mospagësimin e detyrimëve ndaj futbollistëve e për këtë arsye, emra si Pepe e Roko i kanë dhënë lantumirën klubit gjatë javëve të fundit, me shumë lojtarë të tjerë të njohur që pritet të marrin të njëjtën rrugë. Ndaj drejtuesit e klubit kanë filluar kërkimin për alternativa me kosto më të ulët, për të përballuar situatën në vijim. Në një vizitë



në Milano për të diskutuar transferimin e futbollistëve me menaxherin serb Milosh Malenoviç, ky i fundit u ka


propozuar drejtuesve të Beshiktash Gjimshitin, i cili ka eksperiencë ndërkombëtare dhe ka treguar me fanellën e Atalantës e Shqipërisë se mund të luajë në nivelet më të larta. Sipas informacioneve të "Fotospor", menaxheri i ka premtuar se do të zgjidhë ai problemet që mund të lindin me Atalantën nëse do të blokojnë transferimin e mbrojtësit, me detajet mëtejshme që do të diskutohen në ditë në vijim nëse Gjimshiti do të pranojë ofertën për të shkuar në Turqi dhe braktisur Serinë A.

**Flet mbrojtësi i ardhur nga Kamza**

**Frashëri: Më riktheu projekti ambicioz i Teutës**

Projekti që ka Teuta këtë sezon për një vend në Evropë, e pse jo edhe titulli kampion, duke qenë se vendi i parë është më afër se kurrë e kanë bindur korçarin Erlis Frashëri që pas shtatë sezoneve të rikthehet te durrsakët. Në një prononcim që ka dhënë për "Supersport", ai ka pohuar: "Teuta ka një projekt ambicioz, por mbi të gjitha serioz dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore që unë jam rikthyer në Durrës këtë sezon". Natyrisht që në rikthimin e Frashërit në Durrës ka ndikuar edhe njohja që ai ka me trajnerin e Teutës, Bledi Shkëmbin, të cilin e ka pasur edhe shok skuadre kur luante me Skënderbeun. "Unë kam luajtur me Bledin, e kam pasur shok skuadre, por tashmë ai është trajner dhe unë jam ende lojtar. Ndaj edhe do të bëj më të mirën për skuadrën që të justifikoj edhe besimin e trajnerit sepse këtë herë rikthehem në Durrës dhe kam më shumë eksperiencë". Në Durrës, tashmë presin që të zyrtarizojnë edhe dy goditje dhe kështu skuadra do të jetë "top" për pjesën e mbetur të garës. Renato Arapi që thajse është pjesë e durrsakëve, ndërsa pritet dhe një sulmues që sipas drejtuesve të Teutës do të jetë nga më të mirët në Superiore.

### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

1. Janë illogari.
8. Kufizojnë një trup.
10. Janë nocionet e para.
13. Janë vendet si Katari.
14. Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
16. Një pije... darde.
17. Janë me markë në armatura.
19. Artikull spanjoll.
20. Një pjesë e sadistëve.
22. Janë shemra.
27. Fillojnë javën.
28. Janë gratë në Marrakesh.
30. Janë dhoma.
32. Një Ardian guvernator i Bankës.
33. Demek s'ka kufij.
35. Janë centralet si Chernobyl.
38. Mbyllin një dyqan.
40. Një impiant hi-fi.
42. Rolet pa re.
44. Një pjesë e parlamentit.

46. Kufizojnë një send.
47. De Filippi e Amici.
49. Pagëzoi Shën Palin.
52. Ushtrohet një me frysnji.
54. Victorien dramaturg.
55. Eshhtë edhe ai i Zi.
56. Fillojnë tatëpjetën.

**VERTIKAL**

1. Hunt aktore.
2. Nolde piktor.
3. Gjysmw siklet.
4. Marsi në Areopag.
5. Janë antena satelitore.
6. Rrihet në fund.
7. Pak tebaizëm.
8. Janë taksat.
9. Një test.
10. Ferrara regjisor.
11. Eshhtë luftë.
12. Kufizojnë citatat.
15. Një lëndë e organizmit.
18. Qureshin edhe Eumenide.
21. Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
23. Eshhtë si baba.
24. Julia i Familja Addmas.
26. Jules shkrimtar.
28. Mafia pa zë.
29. Role pa zë.
31. Eshhtë zbulurim në skenë.
33. Inicialet e Morricone-s.
34. Irene aktore.
36. Kufij në Oslo.
37. George shkrimtare.
39. U shkrua nga Emile Zola.
41. U shit për një pjatë thjerza.
43. Film shqiptar.
45. Me të nxjerrin trarë.
47. Bega kornik.
48. Eshhtë yll i skuadrës.
50. Fillojnë ndeshjen.
51. Satelit i Uranit.
52. Inicialet e Dukas kompozitor.
53. Mbarojnë fare.

### Fjalëkryqi (2)


**HORIZONTAL**

1. Ndan kapitujt
8. Emri i Gonçarov.
12. Eshhtë e hollë dhe therëse.
13. Inicialet e Stone regjisor.
14. Eshhtë edhe ajo mistral.
15. Kryeqyteti i Marokut.
16. Ki Moon në OKB.
18. Eshhtë lloj papagalli.
19. Një pjesë e amerikanëve.
20. Gjysmë tandem.
21. Hapet me trapano.
23. Një sigël maunesh.
24. Ishtë djali i Odiseut.
26. Eshhtë sherr në shtyp.
27. Artikull spanjoll.
29. Eshhtë zog i verdhë.
30. Mund të jetë kuzhine.
31. Inicialet e Lattuada regjisor.
33. Eshhtë shtet i papës.
35. Mbeten në fund.
36. Pesci aktori.


38. Unë dhe ti.
39. Jepet për hartim.
41. Kërkohe nga poeti.
43. Rastisin në krye.
44. Eshhtë edhe ai i Kuq.
46. I dha fillin Tezeut.
48. Në krye të armatës.
49. I vetmi në orar.
51. Eshhtë ai që premtom të bëhet as.
52. Leblanc që krijoi Arsene Lupin.

**VERTIKAL**


1. Një bukanier.
2. Mosketieri jezuit.
3. Janë zënë në lustë të tillë.
4. Pak analogji.
5. Gishti pa shi
6. Në radhë të parë.
7. Tiriac që qe tenist.
9. Tregohet nga busulla.
10. Kaçaturian kompozitor.
11. Fillojnë natën.
16. Vallëzon me tutu.
17. Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
18. Mund të jenë kursimi.
20. Janë katër në violinë.
21. Janë vendet e pazëna.
22. Në mes të Edgar dhe Poe.
24. Janë ato që na përkasin.
25. Këngëtare italiane.
26. Një pjesë e pavjionit.
27. Braktisi Didonën.
28. Mune të jenë lubrifikantë.
32. Lumë në Francë.
34. Kush është... do të pijë.
37. Nolde piktor.
40. Parashitësë zvogëluese.
42. Zanore arabe.
43. Rastet pa set.
44. Pak dramatike.
45. Maket pa kufij.
47. Inicialet e Nolte aktori.
48. Inicialet e Moravia-s.
50. Kështu përfundin një polic.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	R	M	A	N	D	L	I	N	D	A		
V	A	J	I	E	M	V	E	K	L			
A	D	E	N	L	A	K	E	O	A	Z	E	
T	A	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	
A	P	I	R	A	M	I	D	A	L	E	T	
R	A	F	I	N	E	R	I	T	E	E	L	
F	A	N	A	T	I	K	E	T	H	I		
D	E	N	A	R	A	E	G	E	G			
E	A	J	E	H	E	R	O	N	J			
M	A	R	I	A	N	A	P	I	N	E	D	A
E	T	E	R	E	T	I	K	E	T	A	A	
K	A	T	A	R	A	K	T	A	T	I	M	
A	D	A	M	I	R	E	F	O	R	M	A	T
R	E	K	O	R	D	M	E	N	E	L	A	U
S	R	T	P	E	K	I	N	M	A	R		
E	R	O	S	K	A	N	O	T	A	Z	H	I
N	I	T	R	P	O	L	E	M	I	K	A	T
E	C	P	E	R	I	M	E	T	E	R	M	
K	R	I	J	I	M	N	A	A	T	E		
E	T	K	M	T	I	N	G	R	I	D		
M	A	T	E	R	I	A	L	I	G	U		
I	N	A	T	I	R	U	M	O	A	Z		
L	E	G	J	E	N	I	O	U	N	A		
E	T	E	A	L	T	A	R	E	T	I	T	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

## SUDOK

4	6			2	9
5	7		2	6	
	1		5		8
6	3	4	8	1	7
7		5		3	
	5				
8	9			4	3
6					1
3	4			6	7

## Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	3	5	2	7	8	6	4
2	4	5	9	6	8	7	1	3
6	7	8	1	4	3	9	2	5
7	3	4	2	8	5	1	9	6
5	6	1	3	7	9	2	4	8
8	2	9	6	1	4	3	5	7
9	5	2	8	3	6	4	7	1
3	1	7	4	5	2	6	8	9
4	8	6	7	9	1	5	3	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- Nuk më shqetsojnë muret që kanë veshë, por veshët që kanë mure...

- Një njeri optimist beson se jetojmë në botën më të mirë të mundshme. Një pesimist ka frikë se kjo është e vërtetë.

- "Sa më e madhe sfida, aq më e madhe perspektiva".

- "Arsimi është arma më e fuqishme të cilën ju mund të përdorni për të ndryshuar botën"

## KRIPTOSKEME

## KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

18	3		1	6	9	8	11	8	16	4	8	
18	5	16	4	12	7	3		2		1	14	
8	I	6		3		11		8	8	9	6	1
3	R	9	5	2	7	3	12	8	9	13		12
9	K	5	2	7	3	1	4	8	15	1	4	
9	6	8	12	8	9	7		6		10		
4	3	5	9	7	8	3	5	12	8	9	7	
3		16	1	6	4		7	15	8	1	1	
8	4	1	6	6	1		16	7		7	12	1
13		6	7			11	1	7		4	1	18
11	1	7		17	7	1	12		6	8	17	1
10	13	4	13	3	8	16	4	7	4		1	3

S	U	P	A	I	K	K	U	R	S	I	
A	P	E	R	A	T	U	R	A	H	K	
T	T	O	P	A	T	P	A	P	A	S	
K	E	M	A	L	T	A	K	A	I		
P	A	R	E	T	I	T	R	U	R	I	
R	P	I	A	M	E	L	I	A	S		
E	T	A	T	E	T	L	S	H			
P	O	N	Y	E	R	I	I	U	T		
I	L	T	Y	M	I	E	M	K	E		
T	I	R	A	N	E	T	R	I	M	A	T
E	N	T	I	T	A	N	I	K	E	E	
T	A	U	E	T	K	U	R	A	T		

## Thënie të mençura

- "Një nga kënaqësitë më të mëdha në jetë, është që të bësh gjëra që të tjerët thonë se ju nuk mundeni".
- "Në qoftë se nuk ju pëlqen diçka, ndryshoje atë. Nëse ju nuk mund të ndryshoni atë, ndryshoni mënyrën që ju e shihni atë."
- "Njeriu udhëton në jetën e tij duke u justifikuar për të kaluarën, duke u ankar në lidhje me të tashmen, dhe i frikësuar për të ardhmen."

- "Nga njëherë keni nevojë për tu larguar nga vetja"
- për të parë gjërat më qartë."
- "Nëse duhet t'u tregonim gjithmonë të vërtetën klientëve, nuk do të kishte tregti."
- "Mos thoni se ju nuk keni kohë të mjaftueshme."
- "Ju keni saktesisht të njëjtën kohë që kishte Nëne"
- Tereza, Leonardo Da Vinci, Thomas Jefferson
- dhe Albert Einstein."

